


NÛR

Nr. 9,
1990
Çmimi
2,5 din.

FLETË E SHOQATËS SË NXËNËSVE TË MEDRESESE »ALAUDDIN« PRISHTINË



BOTUES

Shoqata e nxënësve të Medresesë së Mesme
«ALAUD-DIN» – PRISHTINË

KRYEREDAKTOR –
REDAKTOR PËRGJEGJES:
Selatin Shala

KËSHILLI REDAKTUES:
Nexhad Nuhiq, Zekerja Sermagaj
Naim Skenderi, Avni Sadiku,
Refik Gërbeshi, Shaban Haxhiu

REDAKTOR TEKNIK
RUSTEM SPAHIU

FLETA DEL SIPAS MUNDSISË

ADRESA:

Këshilli redaktues i «NUR-IT» – fah. post.
89–38000 Prishtinë, tel. 038/32-472 dhe 32-473

Është lejuar botimi i fletës «NUR-ul-Kur'an» me
vendimin e Sekretariatit për informata të Kuven-
dit të KSA të Kosovës dhe Këshillit ekzekutiv, nr.
01-650-64 të datës 18-03-1975 në Prishtinë.

Dorëshkrimet dhe fotot nuk kthehen

FAQJA PARË E «NUR-it»

NË KËTË NUMËR:

BLOKU TEMATIK MBI KUR'ANIN NE-
XHAT NUHIÇ

BLOKU I TEMAVE TË NDRYSHME ZEKIR-
JA SERMAXHAJ

KËNDI POEZIVE: REFIK GËRBESHI

KURIOZITETE: AVNI SADIKU

INFORMATIVE: NAIM SKËNDERI

PËR PUSHIME E REKREACION SHABAN
HAXHIU

PËRMBAJTJA

FAQE

Të nderuar lexues	3
Letrat e lexuesve	3
Shpallja e Kur'anit	4
Ta njohim Kur'anin	8
Kur'ani libri i Zotit xh.sh.	11
Pozita e egos së Muhamedit as në fenomenin e shpalljes	13
Besimi në All – llahun xh.sh.	15
Islam	17
Një hutbe	18
Mbi jetën e Muhamedit as	19
Sadakatul fitri	20
Pse dhe si duhet ta duam Muhamedin a.s	22
Muhamedi as shembulli më i mirë njerëzorë	23
Thëniet e Muhamedit a.s. për Kur'anin	24
Premtimi (dhënia e fjalës)	25
Shkëndijza islame	26
Ndarja maturantëve	28
Nxënësit dhanë programë mawludi	29
Mawludi në xhaminë e fshatit Ostrozub	29
Nga jeta sportive në Medrese	29
Ne përsim ju përgjigjuni	30
Ju njohim me shokun e ri	30
Puna me vijuesit e mësim – besimit në Prizren	30
Poema e kohës	31
Kur'ani	31
Namaz	32
E kamë një vendbanim	32
Feja Islame	32
Për nder të mawludit	32
Besimtari i ri	33
Enigma numruar	33
Krijuesi	34
A e keni ditur se	34
Plotsimi i fjalëve të ndërprera	34

TË NDERUAR LEXUES!

Qe, me përpjekjet tona modeste, arritëm që ta pregadisim numrin e nëntë të «NURIT» revistë e shoqatës së nxënësve të Medresesë së mesme «Alauddin» në Prishtinë.

Redaksija e re e «Nurit», e zgjedhur në fillim të vitit shkollor vendosi që përmbajtja e «Nurit», afërsisht të jetë e njëjtë sikurse e numrit të kaluar. Si risi kemi rubrikën për më të ritë, zgjerimin e pjesës informatike si dhe më shumë poezi.

Si pjesë tematike e këtij numri është marrë Kur'an, burim i pashterrshëm i diturisë dhe mësimi Islam. Vitet e fundit për ne besimtarët e besimit Islam të kombsisë shqiptare duhet të shënohen me shkronja të arta në historinë e zhvillimit të mendimit fetarë në trevën tonë. U bënë tri përkthime të Kurani-Kerimit në gjuhën shqipe dhe lexohet nga masa e gjerë e besimtarëve.

Në pjesën tematike të «Nurit» mbi Kur'anin edhe ne u munduam që të japim kontributin tonë modest në kuptimin e Kur'anit, sa ia kemi arritur qëllimit këtë le ta thotë lexuesi i nderuar.

Shpresojmë në ndihmën e All-llahut se Nuri në të ardhmen do të jetë më i begatshëm e kjo mvarët edhe nga mundësit materiale.

Si çdo herë besimtarët islam i dolën në ndihmë morale dhe materiale qdo aksioni të dobishëm fe-

tarë. Kemi shpresë se edhe «Nuri» do të hasë në mirëkuptim të lexuesit e vet, K.B.I.-të, tek referencat fetaro-arsimor, imamët e subjektët tjerë, kështu që edhe pse ka përmbajtje modeste, le të shpërndahet sa ma shumë që është e mundur.

Mbesim me shpresë se do të kemi përkrahje dhe bashkëpunim të frytshëm me lexuesit tanë të nderuar.

Njëherit shfrytëzojmë rastin që t'i falënderojmë kolegët tanë nga redaksija e «Zemzemit» fletushkë e shoqatës së nxënësve të M. M. «Gazi. Husrev Beg» të Sarajevës, të cilët në një numër të «Zemzemit» prezentuan «Nurin».

Kohëve të fundit, redaksisë sonë i arrin nga një egzemplar i Zemzemit, e këtë do ta bëjmë edhe ne duke ju dërguar nga dy egzemplarë si motrave tona në Sarajevë dhe Shkup. Jemi të gatshëm dhe me gjithë qenjen tonë përkrahim çdo aksion të ndërmarrë për punë më të suksesshme në të ardhmen.

Të dashur vllazër, «Nuri» është i hapur për të gjithë. Urdhroni, na shkruani, na mësoni, propozoni, sygjeroni e edhe na kritikoni.

ES-SELAMU ALEJKUM
Redaktori

LETRAT E LEXUESEVE

Nga letrat që na arritën në Redaksinë tonë, kësaj radhe po botojmë atë të Ali Ibrahimit nga Shkupi, i cili na shkruan se revista «NÛR» i pëlqen si revistë e re dhe së bashku me këto fjalë i kishte shkruar edhe këto vargje:

«NÛR»

Mirëse vjen te ne
moj revistë e re,
them se nuk është vonë
për ju as për ne.

Ja pra, është në dobi,
për ata që e donë,
do të i gjindet brezit të ri
si herët, si vonë.

Kush e don fjalën e shkruar,
do të jetë mirësi,
dhe sa vepra të botuara
do të ndriqohen përsëri.

«NÛR», me gëzim dhe fat,
të urojmë sukses,
dëshirojmë të jesh ngat
në çdo vend dhe mes.

Shoku Ali, nga Redaksia të falënderojmë për kartëpostalen dhe vargjet dhe dëshirojmë që edhe në të ardhmen «NÛR»-i ynë dhe i Juaji, të jetë afër çdo të riu musliman, i përgaditur sa më mirë.

Lexues të dashur, na shkruani për përshtypjet Tuaja për revistën «NÛR», na dërgoni vërejtje, sugjerime, punime dhe ato do të jenë më se të mirëseardhura për Redaksinë tonë.

Mahsus selam

SHPALLJA E KUR'ANIT

1. Fenomeni i shpalljes

Në definicionin e Kur'anit, që është pranuar në besimin islam, cilësia e parë e Kur'anit është se ky është shpallur, fjala e Zotit e shpallur.¹⁾ Shpallja (vahjun), të folurit e Zotit në besimin islam është në mes të fundamentalizmit dhe kategorive të tij dhe bënë pjesë në terminet më të vështira në shkencën e tefsirit. Mirëpo, ky nuk është termin definitiv dhe shumë dijetarë islam iu përveshën definimit të tij.

Para çdo definicioni tjetër islam, është e nevojshme që vet terminin «shpallje» (vajhun) ta sqarojmë në aspektin lingistik (gjuhësor). Duke marrë parasysh se ajo në citatet e Kur'anit lajmërohet në kontekste të ndryshme. Sistematizuesit e shkencës së tefsirit²⁾ kanë tërhequr vëmendjen në kompleksitetin dhe seriozitetin e vet formulimit të definicionit. Sipas evidencës tekstuale të Kur'anit, fjala «vahjun» nganjëherë përdoret në formën e emrit foljor të pavarur (Vajhun).

Kështu është vepruar dy herë:

a) «Thuaj: Unë po ua tërheqi vërejtjen me shpallje» – Enbija, 45 (Kul innemâ undhirukum bi-l-vahji)

b) «Ky (Kur'ani) është vetëm shpallje e cila shpallet.» – Nexhm, 4 (in huve il-lâ vahjun jûhâ)

Në një formë të këtillë, fjala «shpallje» më nuk përsëritet në Kur'an. Duke marrë parasysh, se ka të bëjë me kontekstin e pamëdyshje (gajru mubhemetin), kjo fjalë është përdorur si sinonim i:

a) Kur'anit,

b) Shpalljes së Kur'anit dhe

c) Të folurit e Zotit (Tevratin, Zeburin, Inxhilin, suhufet, etj.).

Por konteksti qartas flet se ka të bëjë me shpalljen:

a) me fjalët e Zotit e jo me «fizionominë» e Zotit,

b) me fjalët e Zotit e jo me ndonjë gjuhë njerëzore të zgjedhur nga ana e Zotit³⁾ dhe

c) shpalljet e këtyre fjalëve, pejgamberi (i obliguar nga Zoti), të ua transmetojë njerëzve me gjuhë të kuptueshme.

Megjithatë, nëse termini «shpallje» (vahjun) në formën e emrit foljor të pavarur është i pasigurt (mubhemun), ai në format e veta foljore është shumë i komplikuar dhe vështirë është të definohet. Këtu, këto forma është e domosdoshme të ndahen sipas evidencës tekstuale të Kur'anit. Në bazë të kësaj fitojmë kësi rezultate:

1. Veta e tretë, në kohën e kaluar, në formën foljore të katërt (vehâ), përsëritet tetë herë dhe shpeshherë në kontekste të ndryshme:

a) Shpallja pejgamberëve – «E pejgamberëve Zoti i tyre u shpalli...»

/Ibrahim, 13/ (Fe evhâ ilejhim rabbuhum). Kështu kjo folje përsëritet edhe në suret: Nexhm, 10 dhe 11 dhe Isra'39.

b) Inspirimi i shtazëve – «Zoti yt e ka inspiruar bletën...» /Nahl, 68/ (Ve evhâ rabbuke ile-n-nahli).

c) Komunikimi ndërmjet njerëzve (si p.sh. kur Zekerijja nuk mund të fliste, i jep shenjë popullit të vet që «Zotin ta lavdërojnë në mëngjes dhe në mbrëmje».) (Fe evhâ ilejhim en sebbihû bukreten ve'ashijjen) /Merjem, 11/

d) Urdhëresa tokës që të flasë, që përmendet në suren Zilzal, 4. «Atë ditë ajo tregon lajmet e veta (veprat e mira dhe të këqia) që kanë ngjarë në të, sepse Zoti yt e ka urdhëruar.» (Jevmeidhin tuhad-dithu ahbârehâ bi enne rabbeke evhâ lehâ).

Përfundimi themelor që mund të nxirret është se folja (evhâ) në rastet më të shumta, ka të bëjë për Zotin ose diçka që ka të bëjë me prerogativin e Zotit. Por prapë ekzsistojnë shembuj ku një folje e këtillë, ka të bëjë vetëm me njerëz. Analiza e më-tutjeshme e evidentimit tekstual të Kur'anit, do të na tregojë se kuptimi i kësaj folje në vetën e parë njejës dhe shumës (evhajt, evhajná), gjithashtu është shumë i komplikuar dhe nuk paraqitet vetëm në kontesktet ku flitet mbi pejgamberët e Zotit, edhe pse përdorimi i saj këtu është më i shpeshtë: a) Folja (evhajt) paraqitet vetëm një herë në Kur'an dhe këtë në kuptim të urdhërit, «me i lënë diçka dikujt në krah», etj... Kështuqë në suren Maide, 111, thotë: «Dhe kur i frymëzova havarij-junët, (i urdhërova): Të më besoni mua dhe të dërguarit tim.» (Ve idh evhajt ile-l-havarijijne).

b) Folja «evhajná» paraqitet në të shumtën e rasteve në ndonjë rrëfim mbi pejgamberët e Zotit dhe këtë në kuptim të shpalljes dhe transmetimit të fjalëve të Zotit, si p.sh. në suren A'Raf, 160, ku thuhet: «...dhe ia kemi shpallur Musait-kur populli i tij kërkoi ujë...»

(Ve evhajná ilâ Mûsâ idhis-teskuâ kavmuhû).

Megjithatë, edhe kjo folje udhëzon në komplikueshmërinë e definimit preciz se çfarë kuptimi ka shpallja në të vërtetë në lingistikë. Në suren Kasas, 7, ajo përdoret në një kontekst ku plotësisht është e qartë se nuk ka të bëjë me pejgamberin, veq me nënën e pejgamberit, më saktë me nënën e Musaut a.s., «Dhe Ne e inspiruam nënën e Musaut...»

(Ve evhajná ilâ ummi Mûsâ).

Kontekst të ngjashëm kemi edhe në suren Ta Ha, 38, ku evidentimi tekstual, ku tregon se inspirimi i Zotit nuk është vetëm cilësi e pejgamberëve.

këtu thuhet: «Kur e inspiruam nënën tënde me atë që vetëm me inspirim mund të arrihet...» (Idh evhajná ilâ ummike mâ jûhâ).

c) Nganjëherë këtë folje është shumë vështirë ta përkthejmë në gjuhën tonë, si p.sh. teksti: (Ve kedhâlike evhajná ilejke rûhan min emrinâ)/Shura, 52), por me siguri prap ka të bëjë mbi shpalljen dhe dërgimin e Xhibrilit tek pejgamberi. Prapë edhe format tjera të përdorura për shpalljen e Kur'anit janë shumë të komplikuar. Sipas tekstit të Kur'anit, ekzsitojnë edhe këto forma: (nûhî), (nûhîhi), (nûhîha), (lijûhûne), (jûhî), (fejûhiye), (ûhi-je), (vehajná), (vehâhu).

Këtyre duhet të i shtohen edhe format: (jûhâ), (lem Jûha), të cilat padyshim janë të qarta.

Më tutje ky termin përsëritet në të njëjtën formë në suren En'am, 121.: «...Me të vërtetë dajtë i nxisin miqtë e vet që të polemizojnë me ju.» (Ve innesh-shejâtine lejûhûne ilâ evlijâihim lijuxhâdilûkum). Kuptimi i fjalës (lejûhûne), në gjuhën tonë është «me nxitë», e nisë në një drejtim të caktuar, e që prap tregon në disa aspekte, të gjitha këtyre fjalëve që rrjedhin nga rrënja e fjalës arabe (v,h,j).

Nga e tërë kjo që u parashtrua, mund të konkludojmë se të gjitha format e nxjerrura nga rrënja arabe (vehaje) janë të ndryshme dhe mund të qëndrojnë me subjekte të ndryshme por më shpesh përmendet Zoti.

Konkludin tjetër i rëndësishëm është se në të gjitha kontekstet nënkuptohet subjekti i veprimit dhe objekti i tij (kjo është: Zoti u shpallë pejgamberëve, i frymëzon nxënësit e Isaut-havarijjet dhe nënën e Musaut, e frymëzon bletën, e urdhëron tokën etj. Ose prap mund të bëjë me subjektin njerëzor, siqë është përmendur Zekerijja, i cili u jep njerëzve shenjë (krahasoje ende edhe ajetin En'am, 112/, e mund të bëjë edhe me subjektin shpirtëror, kjo është kur shejtani i nxitë ithtarët e vet në polemizim, etj.). Nuk ka dyshim se ky relacion (subjekt-objekt) duhet të kihet parasysh me rastin e definimit të shpalljes në Islam. Sikur që do të vërehet, subhi Salihu këtë e kishte parasysh edhe në bazë të vet Kur'anit, është munduar që ta definonjë shpalljen në islamizëm. Ai thotë: Muhammedi a.s.), individët e zgjedhur pandërprerë e sollën shpalljen nga All-llahu xh.xh. dhe ajo shpallje në të cilën Al-llahu i ka ndihmuar në misionin e tyre, në asnjë mënyrë nuk dallohet nga shpallja të cilën ia dërgoi Muhammedit a.s.. Pra fenomeni i shpalljes mbetet i njëjtë te të gjithë ata, sepse burimin e kanë të njëjtë. All-llahu xh.sh. thotë: «Ne të shpallim ty ashtu siqë i kemi shpallur Nuhit dhe pejgamberëve pas tij, e i kemi shpallur edhe Ibrahimit dhe Ismailit dhe Is-hakut dhe Jakubit dhe nipave të tij dhe Isaut dhe Ejubit dhe Junusit dhe Harunit dhe Sulejmanit, e Davudit ia dhamë Zeburin dhe pejgamberëve mbi të cilët të kemi treguar më parë, mbi të cilët nuk të kemi treguar, e All-llahu sigurisht me Musaun ka biseduar.»

Nga ajeti shihet qartë se pejgamberët e përmendur në të, ishin më të njohurit në mesin e Is-



railitëve. Predikimet mbi ata ishin mjaft të përhapura në mesin e ithtarëve të feve të shpallura (ehlu-l-Kitab), të cilët ishin fqinjë të pejgamberit a.s. në Hixhaz dhe rrethinë.)

Subhi Salihu pastaj përfundon, se Kur'ani me kujdes e ruan terminin «shpallje», për atë që i është shpallur Muhammedit a.s., si do të ishte e mundur kuptimi dhe domethënia e shpalljes, të jetë kundërthënie në mes të gjithë pejgamberëve me terminin e saj, siqë e thotë këtë edhe All-llahu xh.sh.: «Pasha yllin kur përendon, shoku i juaj (Muhammedi) as nuk e ka humbur e as nuk e ka shmangur rrugën e drejtë! Ai nuk flet sipas qejfit të vet. ajo që fletë (ai) është vetëm shpallja që i ka ardhur atij.» (Nexhm, 1-4)

• Si dhe: «...Thuaj (Muhammed): është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur...» (Junus, 15)

Dhe: «E nëse nuk iu sjellë ndonjë ajet, ata thonë: pse vet nuk e trillon! Thuaj (Muhammed): unë shkoj vetëm pas asaj që më ka shpallur Zoti im.» (A'raf, 203)

A është e logjikshme ajo që njerëzit i takojnë të njëjtit lloj, të jetë pengesë që All-llahu të zgjedhë në mesin e tyre atë që Ai dëshiron dhe të i dhurojë dituri, urtësi dhe besim? A është e logjikshme, që kjo dhunti e posaçme të merret si çudi, të cilën bota si të tillë e pranon me habi, e ata të cilët nuk e përqafojnë imanin, këtë e konsiderojnë si një lloj magjie.*)

Me konstatimin e gjenezës, në mes shpalljes së Muhammedit a.s. dhe shpalljes së pejgamberëve tjerë të përmendur dhe jo të përmendur, Kur'ani sipas interpretimit të Subhi Salihut, flet mbi specifitetin e lidhjes së Qenies së Zotit ndaj njerëzve. Në këtë nuk ka çudi, sepse llojet shtazore, edhe në rastin e fundit të gjitha që ekzistojnë, barazohen në pajtim me shpalljen. Mirëpo, për tu kuptuar kjo, patjetër duhet të dihet kuptimi gjuhësor i fjalës (vahjun) dhe fjalëve me të njëjtën zanafillë. Kur feja këtë lloj të shpejtë të transmetimit të fshehtë e ka quajtur «shpallje», ka patur parasysh kuptimin themelor, gjuhësor, të fjalës (îhâun) dhe fjalës (vahjun) – (shpallje dhe inspirim).*)

Në pajtim me përdorimin e fjalës (vahjun) nga vet Kur'ani dhe fjalëve të cilat janë të afërta me

këtë fjalë, Subhi Salihu pohon se këtë fjalë (vahjun) e hasim në Kur'an, në kuptimet si vijon:

- Shpallja (vahjun),⁹⁾
- Inspirimi (ihāun),⁹⁾
- Inspirimi si instinkt shtazor,¹⁰⁾
- Të treguarit momental nëpërmjet simboleve dhe iluzioneve,¹¹⁾
- Shtirja nga shejtani që të bëjë keq njeriu,¹²⁾
- Urdhërat e Zotit melekëve.¹³⁾

Duke e marrur parasysh se nga ky rreshtim, kjo e para është më shpesh lëndë e diciplinave të tefsirit, metodikët e kësaj shkence i kushtuan më shumë kujdes, gjë që edhe është e natyrshme. Nuk ka ndonjë vepër serioze mbi metodologjinë e shkencës së tefsirit (menāhixhu-t-tefsir), e cila nuk merret me të. Ky fenomen i mbinatyrshëm i cili prejardhjen e vet e ka në qenien e Zotit, padyshim në rend të parë është i lidhur për fjalë, gjegjësisht dërgimin e fjalëve të Zotit peygamberëve. Janë tri shikime, të dërgimit të fjalëve të Zotit dhe «këtë kontakt sekret, të fshehtë në mes Zotit dhe të zgjedhurve të Tij, Kur'ani nuk e kufizon vetëm në shpalljen e librave qiellorë nëpërmjet melekut të ngarkuar për shpallje, por me një ajet tjetër aludon në tri mënyra të shpalljes:

1. Shpallja nëpërmjet inspirimit në zemrën e peygamberit,

2. Shpallja nëpërmjet bisedimit me peygamberin pas perdës, siqë ishte rasti kur Zoti xh.sh. bisedoi me Musaun pas lisit dhe ai e dëgjoi thirrjen e Tij dhe

3. Shpalljen, të cilën populli i thjeshtë e i devotshëm e kupton shpalljen gjegjësisht, kur melek u cili është i dërguar nga All-llahu xh.sh. i bien ndonjë peygamberit atë që i caktohet për detyrë, pa marrë parasysh, a i paraqitet peygamberit në fizionominë e ndonjë njeriut ose në formën e vet të vërtetë.¹⁴⁾

Islamizmi nuk është feja e vetme e cila e pranon fenomenin e shpalljes, por me siguri definicionin e shpalljes e ka më specifik. Subhi Salihu vë në pah se nga Kur'ani, pa ndonjë dyshim, mund të kuptohet se kuptimi i shpalljes ishte i njëjtë të të gjithë peygamberët. Mirëpo, nën këtë termin të rëndësishëm, i cili emëron «sekretin, kontaktin e fshehtë në mes Zotit dhe të zgjedhurit të Tij», së paku kur është në mes definicioni islam i shpalljes, në religjionet tjera hasim në definicione tjera lidhur me këtë fenomen. Subhi Salihu pohon se në fjalorin e shkrimit të shenjtë, gjenë sqarime për shpaljet, të cilat në thelb ndryshojnë nga kuptimi unitar dhe i gjithëmbarshtëm. «Sipas këtij fjalori, shpallja është zbritja e shpirtit të Zotit në shpirtin e autorit të inspiruar, për të mundur ata ta kuptojnë më lehtë të vërtetën shpirtërore dhe lajmet sekrete, pa humbur në shpallje asgjë nga personaliteti i tyre. Secili nga këta autorë e ka mënyrën e vet personale të të shkruarit dhe stilin e të predikuarit. Neve na vjen keq që këto pikëpamje këtu ndryshojnë, sepse shpallja sipas definicionit të këtij fjalori, i është larg nga ajo që të jetë në suaza fetare e lidhur për Zotin dhe e marrur nga Zoti, kurse është shumë e afërt me kuptimin e inspi-

rimit, i cili njerëzimit i është i njohur me shikimet subtile si te autorët e frymëzuar, mistikët, gnostikët...¹⁵⁾

Në epokën e psikoanalizës dhe nën ndikimin e saj, ka ardhur deri te interpretimi i gabuar¹⁶⁾ i fjalës «shpalje». Ajo nuk mund të spjegohet si inspirim i poetit, si intinuitë e këndshme, vetëdija e brendshme ose ndërdijes të cilën me kënaqësi e përdorin intelektualët tanë të rinjë, duke i emituar të huajit dhe ata njerëz të cilët i ndjekin të huajit në përpikëri, duke u munduar që me ndihmën e këtyre fjalëve, ose vetëm disa prej tyre, deri në fund dhe me naivitet të shpjegojnë fenomenin e shpalljes tek peygamberët e me këtë edhe te peygamberi i fundit, Muhammedi a.s.¹⁷⁾

Se inspirimi (poetik, artistik etj.) nuk është shpallje, e argumenton edhe ajo se «në të shumtën e rasteve është fryt i punës dhe mundit të madh ose gjurmë e ushtrimit shpirtëror ose rezultat i kontinuitetit, kështuqë në shpirt nuk len bindje të plotë, ose të pjesërishtme por kjo është diç personale dhe intime e participatori i saj, nuk e merr të vërtetën nga burimi i vet më i lartë dhe i madhërueshëm.¹⁸⁾ Argument për këtë, gjithashtu është edhe ky se edhe para Kur'anit (kuptohet në paraqitjen e tij tokësore) ka pasur mu'alaka-jashtëzakonisht të bukura, krijime poetike, vargje, kahine etj; por njeriu arab nuk e ka ndryshuar botkuptimin e tij nën ndikimin e tyre. Me shpalljen e Kur'anit, ky njeri është prekë thellë dhe është nxitur që të besojë në predikimet e qarta të botëkuptimit monoteist.

Pra, gjersa inspirimi nuk mund të krahasohet me shpalljen, duke pasur parasysh se inspirimi është fryt i përjetimit subjektiv, ushtrimit dhe mundit edhe për atë që shpallja e tejkalon në çdo pikëpamje, atëherë as forcat tjera lucide të relacionit njerëzor ndaj botës (iluminizmi, refleksët, etj.) nuk mund të krahasohen me shpalljen dhe janë fryt i mundimit njerëzor, te fenomeni i shpalljes, në islamizëm me rëndësi është të dihet se peygamberi është objekt i saj, ai nuk mund të ndikojë në përmbajtjen e saj, ai nuk e mgjyrosë me subjektivitetin e vet dhe mbetet i pastërt ndaj përmbajtjes së shpalljes, gjegjësisht pa inspirim, ilimunizëm etj; megjithëse në anën tjetër, peygamberi i Zotit në rastet kur nuk i shpalllej shpallja kontepliron, reflekton etj. Shpallja nuk është rezultat i meritës së ndonjë peygamberi të Zotit por i është dhënë si depo, ajo nuk është rezultat i trupit të tij, të drejtë, të pagabueshëm ('ismetun), gjinisë mashkullore etj., por të gjitha këto janë si kusht, pa të cilat nuk mund të i shpallet shpallja. Megjithatë, peygamberi nuk është instrument i thjeshtë i shpalljes së Zotit (siqë e vë në pah në mënyrë të sarkazmës Filip Hiti)¹⁹⁾ por kur e pranon, ndaj saj ka sjellje aktive, ai i bindë bashkëvendësit e vet, ai i bindë se shpalljen nuk mund ta ndryshojë, ai i pari beson në të, me mundime dhe kokërrze të djersës e pranon, etj.

Nën ndikimin e psikoanalizës, dhe psikolizimit të terminave themelore fetare, edhe termini shpallje, përjeton komentime të ndryshme, prej teorisë së epilepsisë deri te teoria e pavetëdijes kolektive.

Edhe pse dihet se njeriu me epilepsi asnjëherë nuk flet në ndikimin e epilepsisë gjëra të menqura dhe me kuptim, edhe pse dihet se Kur'ani me përmbajtjen e vet të amshueshme nuk mund të jetë rezultat i gjendjes së tillë, shumë janë munduar që me këtë teori ta spjegojnë fenomenin e shpalljes në marrëdhënie me personalitetin e perceptuesit të parë, Pejgamberit. Megjithatë, këto janë vështirësi të mëdha sepse është e pakuptueshme dhe e vështirë të sqarohet që nëse pejgamberi është burim i Kur'anit, nuk ka asnjë njohim mbi vdekjen e gruas së tij Hadixhes, vdekjen e Ebu Talibit, vitin dëshpërimit²⁰⁾, nuk ka evidentim teksutal mbi vdekjen e dy bijëve të tij, Kasimit dhe Ibrahimit, etj. Në Kur'an nuk ka diç që ka në veprat letrare, si zhvillimi gradual i fabulës dhe zhvillimi i ideve suksesive. Pra, për ata që këtë nuk e kuptojnë, Kur'ani është i vështirë për të u kuptuar edhe ndërmjetësimi i shemave të dhëna më parë, nuk janë në gjendje që të thellohen në tekstin e shpalljes.²¹⁾ Subhi Salihu mbi këtë thotë: «Natyra e të vërtetave fetare nga ana tjetër e të kuptuarit (el-ahbaru-l-gajbijetu), në lidhje me fenomenin e shpalljes nuk mundet asesi të shpie nën këto forma të pavetëdijes të cilat perden e të panjohurës e përshkujnë me mendjehollësi të madhe, sekrete dhe me intuitë të shpejtë, të brendshme. Kjo natyrë gjithashtu nuk mund të vëhet nën kriterët e jashtëm të të ndieshmëve, të cilët shejtërinë e të panjohurës e ngadhënjëjnë me argumente logjike dhe me rrugë të ngadalshme deduktive. Kjo natyrë, pra i nënshtrohet vetëm nocionit të dialogut më të lartë: Qenies-Urdhëruesit të përsosur dhe Dhuruesit të qenies dhe qenies të cilit i dedikohet të folurit, urdhërat të cilat i pranon.»²²⁾

2. Mënyrat e shpalljes së Kur'anit

Kur'ani nuk është shpallur vetëm në një mënyrë por, në shumë mënyra dhe kjo është shkak që në shkencën e tefsirit të hyjë problemi i këtyre te-

¹⁾Krahaso definicionet «Dete naprijed»

²⁾Shiko: Mebahith, faqe 22 e tutje,

³⁾Kur'ani është gjuhë hyjnore për atë që Zoti e ka zgjedhur për instrument të vetin për komunikim. Zoti gjithmonë zgjedhë që të flet me gjuhën e cila është e vjetër dhe e cila i shprehë të vërtetat më të thella me termine më të thella. (S.H. Nasr, Kur'ani-fjalë e Zotit... faqe 48)

⁴⁾Për Ademin a.s. thuhet se pranoi disa fjalë nga Zoti i tij 6fe telakkâ Âdemu min rabbihi kelimâtin) e që padyshim e bie në lidhje me shpalljen. Dihet se bijtë e tij kanë prerë kurban (Maide 27) e që paraqet rregullin e inicuar me shpallje.

⁵⁾Mebahith, faqe 22.

⁶⁾Ibid., faqe 23

⁷⁾Ibi., faqe 23

⁸⁾Ibid., faqe 23

⁹⁾Shiko: Nexhm, 4

¹⁰⁾Shiko Kasas, 7

¹¹⁾Shiko: Nahl, 68

¹²⁾Shiko: Merjem, 11

¹³⁾Shiko: En'am, 121

¹⁴⁾Shiko: Enfal, 12

¹⁵⁾Mebahith, faqe 25

¹⁶⁾Ibid., faqe 25, 26 (nënvizimet janë tonat)

¹⁷⁾Ibid., faqe 26

¹⁸⁾Ibid., faqe 26

¹⁹⁾Ibid., faqe 26

²⁰⁾Filip Hiti, Istorija arapa, Sarajevë, 1973, faqe 144

matikave. Mirëpo, për të u kuptuar drejtë secila mënyrë e shpalljes së Kur'anit, është e nevojshme që të njihen mënyrat e shpalljes në përgjithësi, të cilat i ka pranuar Muhammedi a.s.. Hanxhiqi, duke u bazuar në burimet klasike islame, vie në përfundim se te Muhammedi a.s. mund të fiksohen gjashtë mënyra të shpalljes në përgjithësi:

1. Ëndrrat e vërteta të cilat plotësisht dhe besnikërisht janë plotësuar kur Muhammedi a.s. ishte në gjendje të zgjuar.¹⁾ Muhammedi a.s. nën ndikimin e këtyre ëndërrave, të cilat plotësisht janë realizuar, ka thënë hadithe ose ka punuar vepra, të cilat për ithtarët e tij janë në rangun e sunnetit.

2. Mënyra e dytë është «që meleku të inspirojë diçka në zemrën e Muhammedit a.s.»²⁾, e që edhe vet hadithi e cekë qartazi.

3. Për mënyrën e tretë të shpalljes në përgjithësi merret paraqitja e melekut në fizionomi të njeriut, e ka pyetur Muhammedin a.s. mbi imanin, islam, ihsanin dhe Ditën e Gjykitit.³⁾ Pastaj i ka vërtetuar përgjegjet e tija, me çka ka vërtetuar se kjo është fjalë e shpallur në rang të hadithit.

4. Mënyra e katërtë e shpalljes përbëhet nga ajo që «Muhammedi a.s. dëgjon dhe kupton zërin i cili është i pakuptuar për njerëzit tjerë. «Ky zë, siç thotë ai, është i ngjashëm me tingullin e bletës. Kjo mënyrë e shpalljes për Muhammedin a.s. ishte më e rënda.»⁴⁾

5. Këtë formë të shpalljes Muhammedi a.s. e ka kuptuar «duke perceptuar melekun në formën e vet, me ndihmën e Zotit»,⁵⁾ kështu që me këtë rast meleku ia ka komunikuar shpalljen dhe rangun i kësaj shpalljeje mund të jetë, p.sh. shpallje vetëm si hadith, hadithi kudsij ose Kur'an, etj..

6. Kur Zoti drejtë përsëdrejti i drejtohet të zgjedhurit. Kjo mënyrë e shpalljes është e rrallë, të cilën e kanë pasur vetëm disa të dërguar të Zotit, si Musau a.s. në kodrën Sina dhe Muhammedi a.s. në mi'raxh.⁶⁾

Nga kjo kuptohet se mënyrat e shpalljes së Kur'anit ndryshojnë dhe se duhet patur kujdes gjatë përcaktimit të mënyrave të shpalljes së Kur'anit. Mënyra e parë dhe e dytë nuk kanë kurfarë lidhje me Kur'anin, por në esencën e tyre janë të lidhura me shpalljen e haditheve.⁷⁾ Kjo është në harmoni me definicionin e haditheve në të cilat thuhet se kuptimi është nga Zoti e fjalët nga Muhammedi a.s.. Pra, këto gjashtë mënyra të shpalljes mund të i ndajmë në:

a) Kur'anore dhe

b) jo kur'anore.

Prej katër mënyrave, në të cilat padyshim është shpallur Kur'ani, mënyra e shënuar nën 4. është shfrytëzuar më shumë, e që shihet qartë nga ky hadith i Muhammedit a.s.:

«Nganjëherë (shpallja) më vie në formë të tingullit të ziles. Kjo është mënyra më e vështirë e pranimit të shpalljes e kur ndërprehej tingulli, unë plotësisht e mbaja në mend atë që më shpallte.»⁸⁾ Mënyra e shpalljes e shënuar nën 3. gjithashtu është e njohur nga hadithi, në të cilin Muhammedi a.s. thotë:

«Nganjëherë më paraqitet meleku në fizionomi të njeriut. Ai më fliste, unë mbaja në mend atë që më thoshte.»⁹⁾

Edhe mënyra e shpalljes e shënuar nën 5. është cekur në hadithin, në të cilin bëhet fjalë mbi shpalljen e pesë ajeteve të para të sures «Alak». Nga ky rrëfim pak më i gjatë i pejgamberit a.s., po i veçojmë fjalët, ku ai përshkruan se si e ka perceptuar melekun:

«...dhe duke shkuar (prej Hiras), kam dëgjuar një zë nga qielli e ngrita shikimin kur mu paraqit i njëjti melek i cili mu paraqit në Hira, rrinte në pozitën në mes qiellit dhe tokës. I frikësuar nga ky, jam kthyer në shtëpi dhe kam thënë: Më mbuloni, më mbuloni!...»¹⁰⁾

Sipas haditheve të dërguarit të Zotit kuptojmë se të gjitha mënyrat (të përfaqësuara nën numrat 3,4 dhe 5) janë të përfaqësuara me rastin e shpalljes së Kur'anit. Karakteristikë tjetër e tyre është se janë mënyra indirekte të shpalljes së fjalës së Zotit. Kjo i ka shtyrë mufessirët që edhe më tutje të themelojnë ndarjen e Kur'anit në:

- a) Indirekte dhe
- b) direkte.

Me shpalljen direkte, në veprat e tefsirit zakonisht mendohet në bisedën e Musaut a.s. në kodrën Sina me Zotin dhe e Muhammedit a.s. në mi'raxh.¹¹⁾ Problemi i cili këtu paraqitet para nesh është se, a ka në literaturën islame të shënuar se disa pjesë të Kur'anit janë shpallur me rastin e shpalljes direkte. Sipas Sujutiut,¹²⁾ në mënyrën e pestë të shpalljes mund të numërohet të folurit e Zotit me pejgamberin dhe këtë në dy mënyra: OSE KUR PEJGAMBERI ishte zgjuar, siç ka ndodhur gjatë udhëtimit natën, ose në gjumë, siç është shënuar në hadithin e Muadhrit, i cili filon me fjalët: «Më erdhi Zoti im dhe më tha...». Sujutiu pohon se në Kur'an nuk ka shpallje të shpallur në gjumë. Mirëpo, fundi i sures «Bekare» si dhe disa pjesë të sures «Duha» dhe «Inshhirah», mund të numërohen si shpallje të shpallura në mi'raxh. Përveç Sujutiut, këtë e pohon edhe ibnu Kethiri,¹³⁾ kurse Zamahsheri¹⁴⁾ konsideron se të folurit e shpallur atëherë, i cili nuk është në Kur'an e i cili thotë: «Xheneti është i ndaluar për pejgamberët derisa të mos hysh ti në të (Muhammed), e gjithashtu është i ndaluar për popujt derisa në të të mos hyjë populli yt.» Shumica e mufessirëve plotësisht pajtohen se shpallja me karakter direkt me të vërtetë ka ndodhur në mi'raxh. Zakonisht mbi këtë flasin duke komentuar fundin e su-

res «Shura», ajeti 51.¹⁵⁾ Këtu nuk duhet posaqërisht të theksohet se Muhammedi a.s. me rastin e mi'raxhit e ka marrë urdherin për namaz, kurse nga «Sahihul-Buharij»¹⁶⁾ kuptohet se me këtë rast ka pranuar tekstin e Kur'anit: «Fjala ime nuk ndërrohet». Ekziston gjithashtu mundësia e dëgjimit të disa pjesëve të Kur'anit në mi'raxh, e të cilat veq ishin të njohura në tokë. I tillë është rasti me shehadein nga leximi i «Et-tehijatu» etj., Shprehja e Kur'anit «pas perdes» duhet të kuptohet, sipas ehlus-sunnetit, në atë mënyrë se pejgamberët nuk e kanë parë Zotin, por kanë biseduar me Të, sikur që thuhet për Musaun a.s.: «Dhe All-llahu i ka folur Musaut me fjalë.»

Shpallja është qështje e fesë, të cilën e pranon vetëm ai i cili beson në të vërtetat e fesë. Zoti i drejtua pejgamberëve të Vet nëpërmes Xhebrailit e njëherit edhe të gjithë njerëzve dhe këtë me të folur. Ai në mesin e disa shqisave njerëzore e zgjodhi të dëgjuarit, sepse të folurit dëgjohej edhe ditën edhe natën. Shqisa e të dëgjuarit është shumë më e përsosur dhe ajo lëndën e perceptimit të vet nuk e përcjellë sikurse syri. Pastaj të folurit është si medium i shpalljes së Zotit dhe është shumë i përshtatshëm dhe me të folur janë dhuruar vetëm njerëzit.

¹¹⁾ Hanxhiqi, citati i cituar, faqe 11.

¹²⁾ Ibid., faqe 11.

¹³⁾ Sahihul-Buhari, përkthimi dhe komenti i Hasan Shakpurit, pjesa e parë, Prijedor, 1974, faqe 74 e në vazhdim.

¹⁴⁾ Hanxhiqi, op. cit., faqe 11.

¹⁵⁾ Ibid., faqe 11.

¹⁶⁾ Ibid., faqe 11.

¹⁷⁾ El-lealiu-l-hisan, faqe 9 dhe 10.

¹⁸⁾ Hanxhiqi, op. cit., faqe 12.

¹⁹⁾ Sahihul-Buhari, faqe 21.

²⁰⁾ Ibid., faqe 21.

²¹⁾ Ibid., faqe 24.

²²⁾ Ibnu Kethir, Tefsirul-Kur'anil-'adhim, tomi IV, Kairo, faqe 121.

²³⁾ Sujutiu, El-itkan fi ulumil-Ku'an, I, faqe 60.

²⁴⁾ Ibnu Kethir, op. cit., faqe 249.

²⁵⁾ Zamahsheri, Keshshaf, IV, Kairo 1972, faqe 29.

²⁶⁾ Ibnu Arebi, Tefsirul-Kur'anil-kerim, II, Bejrut, 1981, faqe 438.

²⁷⁾ Sahihul-Buhari, op. cit., faqe 312.

prof. dr. Omer Nakiqeviq

«Uvod u tefsirsku nauku», Sarajevë

përktheu dhe përshtati R.S.

TA NJOHIM KUR'ANIN

Kur'ani është libri i cili përmbanë tërë shpalljen e Allahut që i është dhënë Muhamedit a.s. pejgamberit të fundit.

– Është burim i fesë islame.

Mus'haf është përmbledhja në formë libri, që përmbanë tërë atë që i është shpallur Muhamedit as.

Mirë është që çdo musliman të dijë sa më tepër hollësi lidhur me historiatin e shpalljes së Kur'anit, shkruarjes, rradhitjes, tubimit në një koleksion (mus-haf), mësimi përmendsh etj.

Në këtë punim kemi për qëllim që t'i njohtojmë lexuesit me ato hollësi që u përmendën, shpresojmë se kanë për ta zgjuar kureshtjen e lexuesit.

– SHPALLJA E PARË

Pejgamberit as. Kur'ani filloi të i shpallet kur ai i kishte 40 vjet. Para kësaj Pejgamberi as. filloi të vetmohoj, zakonisht në shpellën Hirá, jo larg Mekës. Derisa qëndronte në atë gjendje një natë i

lajmërohet meleku i shpaljes dhe i sjell 5 (pesë) ajetet e para të surës Alak. (96:I-5). «Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.»

I tronditur nga ky rast kthehet të bashkëshortja e tij dhe e lajmëron për tërë atë që i kishte ndodhur në shpellën Hirá, e cila i jepë përkrahje të pamasë. Pas kësaj Hatixhja r.a. e njohtoi Vereka ibni Neufelin (për të cillin supozohet se ka ditur Ingjilin përmendsh) i cili i tha: «Pasha Atë te i cili shpirti im është në duar të Tij! Vërtet ai është pejgamberi i këtij populli. Ah sikur të isha gjallë në ditët kur do ta izolojnë... do ta kisha ndihmuar pa masë».¹

E tërë kjo ndodhi në vitin 611. Edhe pse në lidhje me datën e saktë të fillimit të shpalljes dijetarët japin mendime të ndryshme, shiquar në ajetet (97:I dhe 2:185) del se pejgamberlluku i Muhamedit a.s. dhe ajeti i parë i Kur'anit zbriti më 1(një) shkurt 610. me fjalë të tjera ajeti i parë i Kur'anit zbriti në natën e Kadrit të muajit Ramazani sherif.

Pas shpalljes së ajeteve të cituara më lartë pejgamberit i ndërprehet shpallja për një kohë. Kjo periudhë quhet fitretul vahji e cila sipas disa ulemave zgjat tre vjet. Fill pas kësaj periudhe pason faza e dytë e shpalljes duke iu drejtuar pejgamberit as. «O ti i mbuluar (Muhamed) qohu dhe tërhiq vërejtjen.» (74:I-2)

Pas kësaj, vazhdon shpallja e Kur'anit kohë pas kohe duke mos pasur ndonjë ndërprerje të gjatë.

– ZBRITJET MEKASE DHE MEDINASE

Kur'ani i shpallet Pejgamberit a.s. që nga mosha 40 vjeçare e gjer në fund të jetës së tij, rrespektivisht gjatë periudhës 23 vjeçare. Pjesa më e madhe e Kur'anit i shpallet në Meke diku 1/3 ndërsa pjesa tjetër në Medine, apo prej 114 sureve sa ka gjithsej Kur'ani, rreth 90 në Meke e të tjerat në Medine, duke mos mohuar mundësinë që në suret Mekase të gjendet ndonjë ajet Medinas dhe anasjelltas.

Dijetarët u munduan të japin numrin e saktë të shpalljeve Mekase dhe Medinase. Bazuar në këto mendime numri i sureve Mekase sillet rreth 86-93 ndërsa i atyre Medinase 21-28. Zbritjet Mekase në të shumtën e rasteve përbajnë rregullat e besimit, moralit etj., ndërsa ato medinase në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore, urdhëresat, ndalesat, etj. Ajetet të cilat flasin për besimin në të shumtën e rasteve janë të shkurtër dhe mjaft preks, me stil të lartë poetik, e që shumë lehtë përfitojnë ndjenjat e dëgjuesit. Si ilustrim po përmendim ndikimin e ajeteve 1-8 të surës el Hadid në Omerin r.a. që ta pranoi islamizmin.

Fillimin e shpalljes e paraqesin ajeti 1-5 i surës Alek dhe për këtë pajtohen të gjithë dijetarët ndërsa sa i përket ajetit të fundit kemi varianta të shumta. këtu hynë ajetet të cilat flasin për ndali-

min e kamatës (275-279), pastaj ajeti: «Sot përso-sa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhantinë time, zgjodha për ju Islamin fe.» i cili ajet i është shpallur Pejgamberit a.s. në hajjin e lamtumirës. Sipas Seid ibni Xhubejrit, ajeti i fundit është shpallur 8 (tetë) ditë para vdekjes së Pejgamberit a.s. e ai është: «Dhe nëse i frikësohemi ditës kur do t'i ktheheni All-llahut, kur secilit do ti paguhet ajo që e ka fituar dhe atyre nuk u bëhet padrejtësi (2:281)

EMRAT E KURANIT

Shpalljen të cilën Allahu xh. sh. ia dërgoi Muhamedit a.s. e emëroi me shumë emra ku të gjithë dëshmojnë për vlerën e tij të shtrenjtë dhe pozitën e tij të lartë e të pa arritur nga ndonjë libër tjetër.

Emri kryesor dhe që e hasim më së shpeshti është KUR'AN, e që emrohet shpalja që iu dha Muhamedit a.s. në gjuhën arabe. «Këto janë ajetet e librit të qartë. Ne e zbritëm atë Kur'anin arabisht, ashtu që ta kuptoni» (12:1-2) «Pasha Librin (Kur'anin) sqarues. S'ka dyshim se ne e bëmë atë Kur'anin arabisht, në mënyrë që ta kuptoni» (43:2-3) Bazuar në këtë pa pikë dyshimi del se Kur'ani origjinal është vetëm në gjuhën arabe, përkthimi i Kur'anit në ndonjë gjuhë tjetër nuk është Kur'an në kuptim të plotë, múxhize, e as që mund ta kryejmë namazin me të.

Mirëpo duke patur parasysh se Kur'ani është libër i shpallur për gjithë njerzimin, jo vetëm që është i nevojshëm por edhe është detyrë e dijetarëve që të ua paraqesin masës në gjuhën amtare.

Në shumë ajete Kur'ani quhet «El Kitab» që ka kuptim Libër, është potencuar me të njëjtin kuptim në (2:2)

Gjatë leximit shpesh i hasim edhe këto termine: El Furkan, dallus; E Edh-Dhikr, përkujtues; Ettenzil, i zbritur; si dhe një mori cilësish si Drejtus, Mjekus, Mirësi, Qartësi, Argument, Dritë, Mëshirë etj.

TUBIMI I KURANIT NË NJË KOLEKSION

Siq dihet Kur'ani është shkruar qysh gjatë shpalljes, përveç asaj që shumë muslimanë e mësonin përmendsh. Pas shpalljes së çdo ajeti Pejgamberi a.s. i urdhëronte sekretarët e vetë që ta shkruajnë atë mandej ua mësonte edhe vendin dhe suren në të cilën duhej të shkruhej ajeti në fjalë. Shkronjësit më të njohur gjatë jetës së Muhamedit a.s. ishin: Zejd ibni Thabiti, Ali ebi Talibi etj.

Diku një dekadë pas vdekjes së Pejgamberit a.s. rrespektivisht në betejën e Jemamës në luftë me Musejleme Kedh-dhabin humbën jetën mëse 80 hafuza. Ky rast i prekë thellë në zemër të gjithë muslimanët e posaçërisht Omerin, i cili, nga frika se me humbjen e njohsve të Kur'anit po humb edhe ndonjë pjesë e tij i propozon halifit Ebu Bekr që ta tubojnë Kur'anin në një koleksion. Pasi hali-fi pranoi këtë propozim atëherë, formojnë komisionin i cili numronte 20 persona e që ishin nën udhëheqjen e Zejdut. I cili ishte hafiz dhe njëherit njohsi më i njohur i Kur'anit.

Para se të fillojnë punën Ebu Bekri iu jep këtë porosi: «Uluni ju dy në derë të gjamisë (së Pejgamberit) dhe kush do që ju vjen me dy dëshmitarë me diç nga libri i Zotit shkruane ju atë».

Në komentimin që i bënë Ibni Haxheri thënies së Ebu Bekrit thotë: «Fjala dy dëshmitar këtu ka të bëjë me dy që e dinin përmendsh dhe dy që e kishin të shkruar, këtë e ilustron me ajetin 88 të surës Tewbe. Pasi u mblodh Kur'ani, atëherë e lexoi Omeri r.a. para komisionit dhe halifit e pasiqë u pa se nuk ka gabime atëherë të gjithë u pajtuan që kjo përmbledhje të quhet «MUS-HAF»

Sa ishte gjallë Ebu Bekri Mus'hafi u ruajt te ai e pas vdekjes së tij te Omeri, mirëpo përderisa i vie vdekja befas (bëhet atentat) dhe ende ishte pa u zgjedhur halifi, mbetet te Hafseja njëra nga bashkëshortet e Pejgamberit a.s. deri sa vie në krye të shtetit islam Othmani r.a.

Gjatë kohës së sundimit të halifit Othman shtetin islam e përbënin edhe jo arabët, e derisa gjuha e Kur'anit për ta ishte e huaj dëgjohen lexime jo të drejta të Kur'anit, gjë që i shtynë që të bëjnë shumzimin e Kur'anit në disa kopje.

Edhe në këtë rast udhëheqja do t'i besohet Zejdit shkronjësit të trefishtë të Kur'anit, e si bashkëpunëtor i ka: Abdullah ibni Zubejrin Seid ibni Asa dhe Ibnul Harithin. Shumëzimi në kohën e Othmanit u bë duke iu përmbajtur Mus'hafit që u tubua në kohën e Ebu Bekrit. Sa i përket numrit të kopjeve kemi variante të ndryshme e ai sillet /4-10/ dhe ato u dërguan në qendrat më kryesore si «Meke, Basra, Kufe, Damask etj.

Islamizmin vazhdimisht e pranonin edhe popuj joarab, e për derisa Kur'ani ishte ende i pavokalizuar nuk mund ta lexonin drejtë. Për të mos ardhë deri te përçarja e muslimanëve në leximin e Kur'anit, u pa nevoja që të bëhet vokalizimi i tij. Në këtë lëmi kanë dhënë kontribut të gjithë dijetarët e kohës, e pishtar në këtë lëmi numrohet Ebu Esved ed Dueli, pastaj Ubejdullah ibni Zejd el Haxhaxh etj.

PËRSHKRIMI I KUR'ANIT

Duke filluar që nga tubimi i Kur'anit në një koleksion (MUS-HAF) e gjeri te zbulimi i shtypshkronjës, Kur'ani shkruhet me dorë e kjo periudhë zgjatë diku rreth 9 (nëntë) shekuj.

Pishtarët e përshkrimit të Kur'anit u përmendën edhe më parë e ata ishin nën udhëheqjen e Zejd ibni Thabitit e që me propozimin e H. Othman bënë shumëzimin e Kur'anit në disa kopje.

Nuk dihet saktësisht për fatin e mus'hafeve të Osmanit r.a. edhe pse për disa kopje flitet siç është ajo që është pa në Leningrad. Udhëpërshkruesi i njohur Ibni Betuta thotë se, gjatë shetitjeve të tij, ka pa disa nga Mus'hafet e Othmanit r.a. apo pjesë të tyre, në Granadë, Marokë, Basra dhe vende të tjera.

Ky shton: se në gjaminë kryesore në Basra ka parë dorëshkrimin e Mus'hafit të Othmanit r.a. të cilin kur ishte duke e lexuar suren Bekare është bërë atentat në të dhe se në ajetin 2:137 janë pikat e gjakut të tij.

Ibni Kethiri njëri prej dietarëve të shquar të shek. VIIIh. e ka parë mus'hafin i cili ishte dërguar në Sham-Siri.

Ibni Kethiri në librin e tij të quajtur «Fedailul kuran» thotë si vijon: «Sa i përket mus-hafeve të Othmanit, më i njohuri sot është ai i cili gjendet në Sham në gjaminë e Damaskut, në këndin lindor. Ky mus'haf, vazhdon Ibni Kethiri, më parë gjendej në qytetin Tibrij pastaj kah viti 518h. është sjellë në Damaslë...»

Disa studjues dhe gjurmues të mus'hafeve mendojnë se ky mus'hafë një kohë ka qendruar edhe në bibliotekën e Leningradit në Rusi e prej aty është bartur në Londër-Angli.

Kurse disa të tjerë mendojnë se ky mus'haf ka mbetur në xhaminë e Damaskut gjer në vitin 1310 h. atëherë kur është djegur kjo xhami. Ka mendime që njëri prej dorëshkrimeve të mus'hafeve të Othmanit sot gjendet në Muzeun e Turqisë.

Derisa në këtë kohë nuk kishte shtypshkronja rrol të rëndësishëm në ruajtjen e Kur'anit me shkrim kanë luajtur Kaliografet. Njëri ndër kaliografet më të njohur në botën islame është Ibni Mukle i cili jetoi në shek. IX-X. për të cilin thuhet se ka përshkruar hiç më pak se 84 kopje.

Vend meritore në këtë lëmi zë edhe H. Muhammed Muhsin i cili jetoi në Bagdad gjat viteve 1730-1812 e.s. e për të cilin thuhet se ka shkruar më se 72 kopje.

Në Higjaz ka qenë i njohur Halid ibn ebi Hagjaji i cili pat zbkuruar mihrabin e xhamisë së Pejgamberit a.s. dhe i cili i pat përshkruar halifit emevij Velidit mus'hafin përsonal.

Një gjendje e tillë e përcjelljes së kur'anit, duke iu falënderuar kaliografeve, vazhdoi gjer në vitin 1530 kur për herë të parë në Venedik u shtyp Kur'ani në shtypshkronjë, por fatkeqësisht ndalohet nga kisha dhe nuk arrin në duar të dashamirëve të tij. Një botim tjetër do ta bën njëfar Hinkelmani në Hamburg të Gjermanisë në vitin 1694. Pason botimi i Marocit në Padue në vitin 1698, por as njëri e as tjetri nuk zgjon ndonjë interesim të posaqëm të muslimanët.

Botim i parë i Kur'anit nën mbikqyrjen e muslimanëve bëhet në vitin 1787 në Saint Peter-burg në Rusi, pasojnë dy të tjerë në Iran i pari në Teheran në vitin 1828 dhe i dyti në Tibriz më 1833 pastaj në Indi etj.

Botimi më i bukur i Kur'anit, më simpatik, i cili zgjoi interesim të pa parë të muslimanët dhe jo-muslimanët është ai i cili u shtyp në Kairo në vitin 1923 i organizuar dhe pregaditur nga profesorët e Ez'herit dhe komisionit të posaqëm nën udhëheqjen e mbretit Saudit të parë. Vlen të theksohet se ky mus'haf u shtyp sipas transmetimit (rivajetit) të Hafses dhe sipas leximit (kireatit) të Asimit.

Në Jugosllavi përherë të parë është botuar në vitin 1937 në Sarajevë drejtuar nga drejtorja vakufit, tirazhi i tij ishte 10.500 mus'hafa. Ribotimi i dytë me 12.000 ekzemplarë është ribotuar në vitin 1940, Kurse për të tretën herë prej 11.700 ekzemplarë më 1944. Botimi i katërt prej 5.000 mus'hafa u shtyp më 1952 poashtu në Sarajevë.

TË MËSUARIT E KURANIT PËRMENDSH (HIVZI)

Ruajtja e Kur'anit u bë në dy mënyra:

- Përmendsh dhe
- Me shkrim

Siç dihet Kur'ani i zbriti Pejgamberit analfabet, andaj mu për këtë i tërë interesimi i Pejgamberit i kushtohet mësimi, e njëherit i mëson dhe i nxitë edhe shokët që ta mësojnë përmendsh. Zaten kjo ishte në fillim e vetmja mënyrë e ruajtjes ngase, të paktë ishin ata të cilët dinin shkrim lexim.

Arabët kishin prirje për këtë andaj, nuk duhet habitur pse ishte numri aq i madh i hafizave në kohën e Pejgamberit a.s. Në dy beteja (biru maune dhe me murte-dët) humbën jetën mëse 140 hafuza, çka kjoartë jep me kuptuar se në kohën e Pejgamberit numri i hafizeve ishte shumë i madh.

Sjuti në librin e tij të quajtur «El itkanë» cekë me emra disa prej atyre që e mësuan Kur'anin përmendsh gjatë kohës së pejgamberit a.s. Prej muhaxhirve të cilët e mësuan Kur'anin përmendsh cekën: Katër hulefai rashidinët, Talhan, Sâd ibni Mesudin, Hudhejfen, Salimin, Ebu Hurejren, Abdullah ibni Seadin, prej femrave hafize të Kur'anit cek: Aishen, Umi Selman, prej ensarive hafiza të Kur'anit cekë? Ubade bin Usamin, Muadh-in, Megjmâ ibni Gjerijete, Fedale bin ubjd,

Kjo traditë vazhdon edhe pas vdekjes së Pejgamberit a.s.

Dijetari dhe filozofi i njohur Ibni Sina në moshën 10 vjeçare ka ditur tërë Kur'anin përmendsh, kjo nuk i pengoi që në moshën 16 vjeçare të jetë njohës i shumë

shkencave si: Filozofisë, drejtisë, matematikës, fizikës, astronomisë, medicinës etj.

Idrisi - II-të, emiri Marokut i cili jetoi kah fundi shek. VIII-të dhe fillimi i shek. IX-të e dinte tërë Kur'anin përmendsh qysh në moshën 7 vj.

Lexuesi i njohur i Kur'anit në tileavet Abdul Basit-- Abdus-Samed i cili vdiq në vitin 1408h. po ashtu dinte tërë Kur'anin përmendsh qysh në moshën 9 vjeçare, ndërsa në moshën 13 vjeçare dinte të lexoi Kur'anin në shtatë dialektet... E sa e sa të tjerë të cilët nuk mund ti përmendim në këtë rast, e kanë mësuar Kur'anin në këtë moshë (7-10)

As ne në Jugosllavi nuk kemi mbetur pbrapa në këtë lëmi. Në trevën tonë ka pasur dhe ka shumë prej atyre të cilët Kur'anin e mësuan në moshën shumë të re (7-15) përkundër asaj që është në gjuhë të huaj.

- Në vend të përfundimit

Në këtë punim synimi ynë ishte që sado pak dashamirëve të fjalës së shkruar t'i ofrojmë disa njohuri më të përpikta mbi Kur'anin a.s. Për të bërë këtë vështirim më shtyri interesimi i madh i masës dhe pyetjet e shumta në lidhje me, shpalljen e parë, ndarja në sure Mekase dhe Medinase, Emrat e Kur'anit a.s., mënyra e të tubuarit, përcjellja e tij, ruajtja e pyetje të shumta të ngjashme me këto.

Pregaditja jonë nuk na lejon të zgjerohemi ma tepër, por shpresoj se këto të dhëna janë modeste, dhe të nevojshme për çdo musliman.

Selatin Shala
Kl. IV-rtë.

KURANI-LIBRI I ZOTIT xh.sh.

Vështirim:

Besimi në librat e shejta (kitabët) e Zotit është një ndër themelet e besimit. Allahu xh. sh. pasi që e krijoi njeriun ja dhuroi edhe porosinë e Tij, që mos të humbi rrugën e drejtë islame. Fjalën e vet i madhrishmi e ndriçoi me anë të dërguarve të vetë njerëzimit. Por, të dërguarit e Zotit gjatë misionit të tyre u ndeshën në shumë barikada të fuqishme për të kryer detyrën e vetë që ishin të urdhëruar nga Allahu xh.sh. Çdo popull kërkonte më së pari prej të dërguarve të Allahut dëshmi bindëse që të argumentojnë atë që e thonë. Të përmendim në këtë rast disa pejgaber të cilët për të ia vërtetuar popullit të vetë se është i dërguar i Alahut xh.sh. si Nuhi a.s., Salihu, Ibrahim, Musa, Isau, dhe Muhamedi s.a.v.s. kanë përdorur vepra të mbinatyrshme (el-mu'gjizetu). Si mu'gjize kemi dy lloje të mu'gjizeve:

I) (Hisije) - shqisore, lëndore

II) (Aklije) - kuptimore, mendore.

Mrekullitë Hiusije janë shqisore ose lëndore, ngase mund ti përfetojmë me anë të shqisave, nga se ato paraqitën fizikisht dhe janë objekt i përjetimit të shqisave. Mrekulli të këtij lloji pati shumë

si: shendrimi i nxehtësisë së zjarrit në shpëtim, në të cilin qe hedhur Ibrahim a.s., Shendrimi i shkopit të Musaut në gjarpër. shendrimi i zogut të mbaruar prej balte në zog të gjallë, në kohën e Isaut a.s. dhe shumë sosh që kanë ndodhur në kohën e Muhamedit a.s. Lloji i mrekullive hisije edhe pse janë fakte bindëse shumë të forta dhe praktike, me kalimin e kohës, pas disa gjeneratash ato harrohen. Mrekullitë akeije janë mrekulli më të fuqishme dhe permanente dhe më efikase se sa ato shqisore. Se efekti i tyre do të shërbejë si udhërrëfyes në të gjitha kohrat dhe ndodhitë. E ndër këto mrekulli është Kur'ani i shpallur Muhamedit a.s. që njëherit është edhe prej cilësive të Zotit (kelamull-llah), të folurit e Tij është permanent dhe i pashtershëm, me plotë kuptim, burim i pashtershëm deri në ditën e gjykimit. Të gjitha mrekullitë para Muhamedit a.s. kanë qenë të përkohshme dhe të caktuara për një vend, për një kohë dhe për rrethin e njerëzve të caktuar. Edhe i dërguari ka hasur në kundërshtime të forta me mushrikët kur-rejshë (Mekasit), të cilët me të gjitha mjetet mundoheshin ta ruanin fenë e stërgjyshve të tyre, që ta zhdukun atë dhe fenë e Zotit, përkatësisht Kur'anin.

Por mundimet iu shkuan kot, nuk mundën që t'ia arrinë qëllimit që ta shkatrojnë fjalën e Zotit, as atëherë nuk iu ka shkuar për dore por, edhe as sot nuk do të iu shkon për dore, sepse «Kurani është fjalë e Zotit» e cila nuk guxon të pushoi. I dërguari Muhamedi a.s. siq e dimë nga historia, se u shpall si peygamber në vitin 610 ku shpallja e parë i erdhi në shpellën «Hira». Në atë kohë në Meke ishte shumë e zhvilluar oratoria e cila kishte mbërritur kulminacionin e shkathtësisë, gjë që askush nuk mund të krahasohej me ta në atë kohë. Mu në këtë kohë u lajërua edhe Kur'an i a.s. por, në atë kohë kur u shpall Kur'an i Arabinë në përgjithësi e kishte përfshi një errësirë e madhe e mos kulturës, besimi i tyre ishte në idhuj, morali kishte rënë në një nivel të ulët, aventurat ishin përhapur shumë pra, në atë kohë u shpall fjala e Zotit (KELAMU-IL-LLAH) Kur'an i a.s.

Teksti Kur'anor në shikim të parë duket se ndahet në prozë, poezi apo diç të tretë.

Nuk është çudi kur Velid bin Mugire, përkundër urrejtjes të pakufizuar ndaj islamizmit, të cilën e mbajti gjer në vdekje, nuk mundi ta fsheh mahnitjen e tij ndaj Kur'anit, kur idhujtarët kërkuan prej tij që të bëj diç apo të ngjashme me Kur'anin, pasi që ai në atë kohë ishte një ndër njohsit me të mirë të prozës dhe poezisë, në ç'rast tha: «Për Zotin në fjalët e tij ka diçka të këndshme, ëmbëlsi dhe saktësi. Fjala është e dobishme, e plleshme dhe e përsosur, si ajo nuk ka» (El-Kur'an muhaweretun lifehmi n'asrijijn, Mustafa Mahmudi. Bot, i dytë, Kairo 1977, f. 13. Prk: N. I)

Në kohën kur filloi i Dërguari a.s. të predikoi Kur'anin atëherë armiqët e islamizmit filluan të thonë se kjo është një farë magjie e cila e ndanë të atin prej të birit, vllaun prej vllaun, Burrin prej gruas dhe njeriun prej familjes.

Than se i dërguari është i marrë i cili po flet tregime të popujve të vjetër. Po, Kur'an i është magji që e largon njeriun prej rrugës që e shpie njeriun në humnerë të thellë i cili s'mundet të del pa i ndihmuar dikush, pra arabve dhe gjithë njerëzve të tjerë ia dha dritën e syve të tyre Kur'an i, i largoi prej çdo humbje dhe i shpiu në rrugë të drejtë islame.

Kur'an i është libër hyjnor që përveq dobive që na i sjell zbatimi në praktikë i dispozitave të tija, vetë leximi i tij dhe përkujtimi i domethëniesve të tij është ibadet. Të gjitha këto thënie të mushrikve Kur'an i thjeshtë e lehtë i demanton dhe mu këtu armiqët e përbetur i nxitë dhe i ngacmon të bëjnë diç të njëjtë apo të ngjashme me Kur'anin, në mënyrë që të ua tregoi paaftësinë e tyre. Ai i thërret mohusit (Kafirrat) që të bëjnë rikthesë siç bëri Kur'an i. këto thirrje ende janë të hapura po edhe do të jenë gjithmonë, ai pret i gatshëm që të garonë në çdo pikëpamje. Ku i lartmadhërisht Zot në Kur'an thot:

«Dhe nëse dyshoni në atë që ia kemi shpallur robit tonë, bëne ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'an i), mandej thirni edhe dëshmitarët tuaj, në vend të Allahut, nëse flitni të vërtetën» (S. Bekare 23.)

«E kur prej nesh u dëshmuar e vërteta, ata thanë, pse nuk i është dhënë ashtu, njëlloj, siç iu dha Musas? Vallë, a nuk e patën mohuar ata qysh më herët atë që ishte dhënë Musas? Ata thonë «Dy magji të cilat përmbajnë njëra tjetrën, dhe shtojnë – Ne në asnjërën nuk besojmë».

«Thuaj, sillne ju nga Allahu një libër që drejton në rrugë të drejtë më mirë se këta dy, do ta kisha pranuar nëse jeni të sinqertë» (28:49) «Thuaj: sikur të bashkoheshin tërë xhinët dhe njerëzit të bënin një Kur'an sikur ky, nuk do të mundnin të bënin, edhe po qese i ndihmojnë njëri tjetrit» (17:88)

Nuk kemi mundësi kursesi të mohojmë se nuk kishte tentime për emitimin e Kur'anit, por mund të vërejmë-konstatojmë se këto tentime mbetën vetëm tentime. Kur'an i është udhërrëfyes për gjithë njerëzit që i besojnë fjalës së Zotit dhe që dëshirojnë të jetojnë me të, sepse ai është fjalë e Zotit ai është udhërrëfyes për të gjithë ata të cilët i përmbahen këshillave dhe mësimëve të tij. Besimtarëve dhe adhuresve të vërtetë dhe të sinqertë Allahu në Kur'an u premtan dhe garanton siguri, jetë të qetë, të lumtur dhe pa brengë. Njeriut bashkohor të cilit zbulimet e mëdha shkencore, teknike dhe teknologjike, dalngadal po ia uzurpojnë funksionet një nga një, mësimi islamë (Kur'anor) i ofron optimizëm që njeriu mos të jetoj i ngarkuar me ndjenja të pasigurisë, sepse sipas mësimi islamë: njeriu për njeriun nuk është ujë. Përkundrazi njeriu i plotë islam, është i fortë për vetvetën dhe krah i fortë konstruktiv i mesit ku vepron dhe punon. Nëse kushdo qoftë, Kur'anin e konsideron vepër shkencore, ai do të ishte i padrejtë ndaj tij sepse një identifikim i këtillë do të kishte pretendime për të devaluat vlerën reale të Kur'anit si fjalë e pastërt, e fuqishme dhe e ngjeshur mbinjerëzore, si fjalë e Zotit. Kur'an i është libri i cili i mohoi besimet e kota të mushrikëve kurejsh të cilët besonin në shumë zotra, politeizëm, dhe e themeloi besimin në një Zot krijues të çdo gjëje. I vuiri themelet e islamizmit përgjithmonë, dhe me thesarin e pastërt të dispozitave i rregulloi rregullat e moralit dhe i rregulloi marrëdhëniet ndërnjerëzore. Kur'an i bëri kthesë të madhe në këto marrëdhënie ndërfinnore dhe ndërnjerëzore ndër popullin arab të atëhershëm por, edhe ndër popujt e botës në përgjithësi. Siç e dimë se në kohën para ardhjes së Muhamedit a.s. dhe gjatë 40 vjetëve që ka jetuar, pa i ardhur shpallja zhvilloheshin lufta të mëdha. Iu kanosej rreziku edhe shumë fiseve arabe që totalisht të shkatroheshin, zullumi dhe padrejtësia zhvilloheshin në masë të madhe, morali kishte rënë në një nivel të ulët, pra çdo gjëje i kanosej rreziku. I madhi Zot e dërgoi Muhammedin a.s. që ta udhëzoi atë popull të humbur në rrugë të drejtë islame s'do mendë se përjetuan mundime Muhammedi a.s. edhe besimtarët, por me ndihmën e Allahut ia arritën qëllimit.

Kur'an i i grisi të gjitha perdet e kohës, të vendit dhe depërtoi e zbuloi edhe në ato fshehtësi që fshihen në zemrën apo mendjen e njeriut. Edhe në shekullin tonë i cili konsiderohet si shekull i mësimi dhe kulturës mendore, fjala Kur'anit duket se

zgjerohet dhe jep kuptim të ri, sa herë dituria me përpjekjet e veta bën kthesë në zhvillimin e jetës, e ajo gjen mbështetje në thëniet e Kur'anit dhe thëniet e tija duket se po përtrihen gjatë shekujve për çdo gjeneratë, e kështu dokumentohet se mësimi i tij është i ri për çdo kohë dhe se ai mësim kurr nuk vjetrohet, sepse duke e zgjeruar terenin e kuptimeve, shkon paralelisht me zhvillimin e jetës, prandaj është mrekulli mendore. Allahu në Kur'an thotë: për ruajtjen e tij gjatë shekujve se është garancë e tij, dhe se do të jetoj sa edhe njerëzimi (I) kush mund të pranoi shpalljen prej Allahut xh. sh?

Siç e dimë ne, njeriu është krijesë e dobët, por është edhe qenie materiale atëherë nuk mundet që të i pranoi fjalët e Allahut xh. sh. Për t'i pranuar fjalët prej Allahut nevojitet me qenë qenie më e lartë se njeriu që nuk është materiale. Pasiqë, qenie jo materiale janë melekët, ja edhe Allahu i madhrishëm e zgjodhi si bartës të shpalljeve melekun xhibrilin a.s. si krijesë e lartë dhe jo materiale. Ajo krijesë e cila është jo qenie materiale mund të pranoj shpaljen prej Allahut dhe t'ia transmetoj njeriut, siç është shembulli i Muhamedit a.s. i cili e ka pranuar shpalljen prej Allahut me anën e melekut. Por, edhe ashtu kur takohen dy loje të qenieve me përbërje të ndryshme, njëri i llojit të ulët e tjetri i llojit të lartë melek, mirëpo edhe takimi i atyre dy lloj qenieve nëse nuk bëhet në njërin ndryshim atëherë komunikimi është i pamundshëm. Nëse qenia e lartë e bënë ndryshimin e vet atëherë për njeriun (të dërguarin) është shumë më lehtë por në qoftë se ndodhë e kundërta atëherë për, njeriun është shumë më rëndë. Kur Xhibrili a.s. merrte formën e njeriut Muhamedi as nuk bënte përpjekje për ndryshimin e qenies së vetë. Por kur xhibrili mbetej në formën e vetë, Muhamedi e kishte shumë më vështirë sepse atëherë qenia organike nevojitej pa tjetër të ndryshohej. Në

atë rast qenia materiale e njeriut, dukej se pushonte nga funksioni, nuk prezentohet, tërë fuqinë e merr shpirti sepse shpirti është qenie më e lartë, dhe si i tillë mund të kontaktoi me melekun, i cili gjithashtu është qenie e lartë. E kur të mbaroi të merr fund angazhimi dhe ta ket pranuar atë që është dashur, atëher prapë kthehet në gjendjen e mëparshme në gjendjen e rëndomtë.

Në një hadith peygamberi e sharon këtë çështje shumë kurtë e thotë: nganjëherë (shpallja) më vjen në formë të tingullit të zilës, e kjo për mua është më e vështirë, e kur më ndërprehet unë plotësisht e mbaj në mend atë që më shpalli Xhibrili a.s.

Allahu Kur'anin e shpalli të përvetshëm, duke qenë udhëzim e mëshirë për individin dhe për bashkësinë njerëzore. Ai dërgoi këshilla në një nivel të lartë edukativ, që kultivon dashuri dhe mbjell paqë ndër njerëz.

Kur'ani është mrekulli e përvetshme ngase është atribut (sifat) i Zotit të përvetshëm. Sa për përfundim po e cekim edhe këtë, se Kur'ani është fjalë e Zotit i cili me bukurin e të shprehurit dhe përmbytjes i tejkalon mundësitë dhe aftësitë e njeriut... Ai paraqet formulimin e fundit e definitiv hyjnor të drejtuar mbarë gjinisë njerëzore. Kur'ani ka rrugën e tij të zhvillimit (material), natyrisht edhe vështirësitë të cilat e përcjellin çdo shfaqje. Hyjnija e Kur'anit është e qartë në çdo hapë. In shaall-llahu na bënë prej atyre të cilët nuk i kundërshtojnë urdhrat dhe udhëzimet e fjalës së Zotit (Kur'anin) që na janë dedikuar neve këto udhëzime për të udhëhequr rrugën tonë të plotë islame.

FLAMUR SOFIU
KL. II-të

LITERATURA:

Takvimi 1982 nga Nexhat Ibrahim.
Nga përkthimi i Kur'anit Sh.A.

MALIK IBN NEBI:

POZITA E EGOS SË MUHAMEDIT NË FENOMENIN E SHPALLJES

«Lexo!»

«Nuk di të lexoj.»

Ky dialog i pazakonshëm i cili për botën don të thotë fillimi i erës kur'anore, sot mund të ofrojë një element shumë të rëndësishëm për studimin psikoanalitik të fenomenit të vahjit. Ky është dia-

logu i vetëm i shënuar historikisht, në të cilin Un-i i Muhamedit përgjigjet qartë, me ton të zëshëm, zërit i cili së shpejti do të lajmërojë misionin e tij.

Halucinacione?

Duke mos marrë parasysh rrjedhën e vet historike – e cila do të përfshijë periudhën prej njëzetë viteve – paraqitja, të cilën këtu e shqyrtojmë është në gjendjen fillestare audio-vizuele. Megjithatë, halucionacionet e këtij lloji formohen në bazë të ëndërrës; halucinacionet hipnagogjike kur un-i i vetëdijshëm është në kufirin që të futet në ëndërr dhe halucionacionet hipnagogjike kur vetëdija nga ai fundoset. Si në njërin, ashtu edhe në rastin tjetër, psikiatria ka vënë re, tek personat normalë sikur është Muhammedi a.s., thyerje të paraqitjes së halucionacionit me një shkak lëvizës, sikur është shqiptimi i tingujve të kuptueshëm. Ky është në të vërtetë rasti ynë, sepse në dialogun e lartëshënuar, shkaku lëvizës u përsërit tri herë. Nëse do të ishte e mundur që halucionacioni të mos thyhet me pje-

sën e parë të dialogut, ai nuk do të mund të qëndronte pas goditjes së parë kumbuese, në kohën e atyre dy të fundit, çka në këtë rast mbetet e pasqaruar. Kështuqë, duke mos paragjykuar asgjë në vet natyrën e dukurisë, prapëseprapë është e pamundëshme të sqarohet si ndonjë halucinacion. Nga ana tjetër, nga shikimi i jashtëm, dialogu i më sipërmë, menjëherë e cakton pozitën relative të Un-it të Muhammedit në të folurit kur'anor ku ai gjendet, veq nga shpallja e parë, në vetën e dytë të njëjtësit. Në të vërtetë, me një Ti të këtyrë i drejtohet të folurit kur'anor, nga goja e një UN-i, i cili këtu pa ndërmjetësim paraqet gjuhën hyjnore, sido ti urdhëronte një ummijj-it, i cili në këtë rol nuk mund ta paramendojë veten dhe për këtë është i shqetësuar.

Pyetja këtu përbëhet në atë që të dijmë se a është e mundur psikologjikisht, që kjo Ti dhe kjo Unë të bashkëdyzohen në një Unë, atë të Muhammedit.

Duhet menjëherë të vëmë re kontradiktën qenësore dhe të dukshme në këtë dialog, në mes të kësaj Unë, i cili në mënyrë komanduese urdhëron dhe të kësaj Ti, të shqetësuar i cili tërhiqet prapa. Kjo tërheqje prapa, natyrisht paraqitet tek subjekti i cili e di se nuk di të lexojë, vetëdijen dhe njohjen që e ka për vetveten. Përgjegjja e tij negative, e frikshme por precize, paraqet përfundim normal të procesit psikologjik, i cili rrjedhë nga ajo njohje personale dhe përsosmërisht pozitive të ummijjetit të vet.

A nuk duket se ky urdhër komandues, para të cilit tërhiqet ky ummijj, mohon apo nuk pranon atë koncept pozitiv?

Këto kontradikta, në çdo mënyrë karakterizojnë një proces tjetër psikologjik, krejtësisht të ndryshëm nga i pari, por i cili paraqitet njëkohësisht me të, pasi që që të dy gërshetohen dhe prehen në të njëjtin moment, kur Un-i urdhëron atëherë edhe Ti i shqetësuar tërhiqet prapa. A mundet ky sinkronizim i dy proceseve divergjente të mendohet në të njëjtin Unë të vetëm, i cili ashtu do ti përfshinte të dy pjesëmarrësit në dialog? Në çdo rast, këto dy kushte, divergjenca dhe sinkronizimi – janë në kundërtënie, qoftë nëse i vështrojmë në njërin apo në planin tjetër të këtij Unë, qoftë në dy plane të kundërta, të vetëdijes dhe subkoshientin (të nënvetëdijes). Detyrimisht, në rastin tonë ekzistojnë më shumë Unë, të cilët është e pamundur të përfshihen në thelbin e njëjtë psikik. Në të vërtetë, këtu jemi të detyruar të pranojmë dualitetin e Un-it, sikur në bisedën më të thjeshtë.

Natyrisht, në mes të këtyre dy Unë, të cilët bisedojnë, theksohet Un-i i Muhammedit, dëshmitar i sinqertë, i ndërgjegjshëm dhe historik i faktit të cilin e analizojnë.

Përveç tjerash, ky është rasti i vetëm, në të cilin ky Unë shprehet aq qartë në fenomenin e mrekullueshëm të Kur'anit. Kjo është hera e vetme kur ai vendosmërisht do të marrë pozitë të qartë dhe të pëlqyeshme në raport me Un-in e bashkëbiseduesit, i cili me një anomali subtile dhe haptas iracionale, i urdhëron një analfabetit në hutinë e tij që të lexojë.

Pas kësaj edhe asnjëherë tjetër, Un-i i Muhammedit nuk do të marrë fjalën që të polemizojë me Un-in i cili i flet. Kjo heshtje është në vetvete mjaft e kuptueshme sepse tregon se Muhammedi a.s. më në fund u bë i vetëdijshëm për fenomenin, në të cilin ai merr qëndrim pasiv. Un-i i tij do të mbetet përgjithmonë i pagojë në të folurit Kur'anor, i cili në asnjë mënyrë nuk do të shprehë zgjidhje të biografisë së tij private. Kurrfarë pasqyrimi, për shembull, të dhembjes së tij kur e humbi bashkëshorten e vet të urtë dhe axhën më të dashur. Ne megjithatë e dimë se sa dashuri ka pasur Muhammedi a.s. ndaj këtyre dy qenieve.

Këto shqyrtime në jopersonifikimin e të folurit Hyjnor, në të cilin Muhammedi a.s. paraqitet në vetën e dytë të njëjtësit, mund të theksohen edhe më. ka në të vërtetë ajete, në formën e veçantë të të cilëve tërheqë vërejtjen roli i pazakonshëm të cilin e ka këtu Un-i i Muhammedit. Ja një shembull:

«Ai ua mundëson që të udhëtoi nëpër tokë dhe det. E kur ju të gjendeni në barkë dhe ajo lundron me ju në erën e përshtatshme, e ata i gëzohen kësaj, arrinë një stuhi dhe ata do t'i sulmojnë valët nga të gjitha anët...» (Kur'an, X:22)

Në këtë ajet, kalimi jonormal nga përemri ju në përemrin ata është shumë i rëndësishëm sepse ai nuk do të mund të sqarohet si gabim gramatikor – i paparamenduar në stilin, përsosmëria letrare e të cilit, në të vërtetë ka ofruar argumentin më të fuqishëm të misionit të Muhammedit a.s..

Prandaj, sikur të ishte fjala vetëm për gabim, do të ishte i nevojshëm ndonjë përmirësim, çka do të ishte e mundur dhe e lehtë për tu bërë më pastaj. Nëse këtë nuk e ka bërë i Dërguari i cili e ka recituar Kur'anin për vete dhe që këtë ta mësonin shokët e tij, kjo implikon se ajo anomali në sytë e tij nuk ka pasur karakterin e gabimit. Nga ana tjetër, kjo dëshmon se Muhammedi a.s. nuk ka përvetësuar asfarë të drejte cenzure në pikëpamje të tekstit Kur'anor.

Fundja, në këtu nuk do të analizojmë aspektin letrar të çështjes por vetëm nga aspekti i analizës psikike. Pra, anomalia e vështruar mbetet rast i shquar ku Un-i i Muhammedit paraqitet në mënyrë eksplicite dhe të vazhdueshme në dy role të ndryshme; ai është në mënyrë direkte bashkëbisedues i interesuar i futur në ju të cilit i drejtohet të folurit. Pastaj ai bëhet dëshmitar i interesuar në mënyrë indirekte dhe i vendosur, në kalim e sipër, para skenës së aksionit të dhënë, në vetën e tretë të shumës. Ky kapërcim i papritur implikon dy gjendje psikologjike, prej të cilave e dyta – këtu kemi të bëjmë me Un-in e Muhammedit – mund të rezultojë vetëm nga shthurja e të parës, ose të bëhet vetë ajo shthurje. Thënë ndryshe, në ajetin e mësipërm, ata do të duhej të jetë ai vetë, pasoja direkte psikologjike e ju ose kjo të varet nga pasoja indirekte. sido që të jetë, domosdo do të ekzistojë ndonjë lidhje logjike ose psikologjike, në mënyrë që ajeti i analizuar të mund të arsyetohet me një Unë të thjeshtë njerëzor. Lidhja logjike, si po shihet, nuk ekziston, pasi që nga rasti i tij ka të bëjë – së paku nga pikëpamja gramatikore – me ga-

bimin e papajtuësëm me UN-in mendimor të Muhammedit, i cili na ka lënë dëshmi të pasura në përmbajtjen e tij personale letrare në hadithe ku nuk hasim asnjë formë të ngjashme. Këtë vërejtje duhet, kalimthi ta shqyrtojmë edhe si një shenjë të papersonifikimit, e cila e karakterizon stilin e Kur'anit.

Sa i përket aspektit psikologjik, duhet vërejtur se kalimi nga ju në ata – subjektet konsektivë në ajet – megjithatë nuk don të thotë kapërcim në natyrën e aksionit. Në të vërtetë, në ajetin e hulumtuar, foljet japin të njëjtën paraqitje në të njëjtën pamje, përderisa subjektet haptazi janë ndër-ruar. Ky kapërcim është i pjesërishëm, prandaj a është e mundur që nga ky shkak të i përshkruhet ndonjë asociacioni ideja e përshtatjes në Un-in e nënvetëdijshëm të Muhammedit?

Kur paraqitet asociacioni i ideve në temat e subkoshientes – posaçërisht në ëndërra – ajo modifikon jo vetëm pozitat relative të kryefjalës, bartjen e saj nga një person në tjetrin, porse ndërrohen edhe vet kryefjalët si dhe aksioni i tyre. Këtu në të vërtetë ekziston një subjekt implicit në formën e Un-it të Muhammedit, pozita e të cilit ndërrohet në raport me subjektin eksplisit, porse vazhdohet aksioni plotësisht i njëjtë në ajetin e vështruar. Nga kjo arsye, këtu nuk mund të pranohet asociacioni i ideve si shkak psikologjik i cili e ka caktuar modifikimin e kufizuar, i cili paraqitet vetëm në aspektin gramatikor të ajetit, e që

krahas kësaj të mos ndërrohet asnjë detaj i skenës.

Egzegeza klasike veç e ka shqyrtuar këtë problem me emrin iltifat. Iltifat është interpretimi i jashtëm i thjeshtë i problemit, për të cilin kërkojmë qelës, thjeshtë interpretim letrar, i cili sipas pikëvështrimit psikologjik do të mund të nënkuptonte, në esencë, akt të vetëdijshëm, i cili ndriçon nga një Unë i dëshiruar, nga multefiti. Kjo, për këtë shkak nuk do të mund të ofronte sqarimin të cilin e dëshirojmë dtth. nga aspekti i analizës psikike, përveç të modifikojmë të gjitha të dhënat, të cilat i vërtetuan në pikëpamjen e Un-it të Muhammedit.

Definitivisht, sadoqë kjo e çrregullon shprehinë karteziane, e cila e mbyllë të kuptuarit në rregullat e pozitivizmit të ngushtë, jemi të detyruar që të kërkojmë qelësin e problemit diku tjetër, e jo në psikizmin e thjeshtë të UN-it të Muhammedit.

Është e nevojshme që të kërkojmë qelësin e problemit diku tjetër, e jo në që të shqyrtojmë një rrafsh tjetër, ku në vet fillimin përpunohet fenomeni Kur'anor, para ndikimit të tij në Un-in njerëzor, i cili e thekson. Prandaj, pasi që nuk ka arsye që atë rrafsh ta transferojmë në një tjetër Unë njerëzor, do të ishte e nevojshme që ta shohim në mënyrë të pashmangshme në metasikizmin, i cili me Un-in e Muhammedit ka lidhje të thjeshtë në Vahj.

Nga: Kur'anski fenomen, Sarajevë.
Shqipëroi: Ekrem AVDIU

BESIMI NË ALL-LLAHUN xh.xh.

«El-Imanu en tu'mine bil-lahi»

– Muhammedi a.s. ka thënë: «Iman është të besosh në Allahun...»

Transmetohet se në kohën e Muhammedit a.s., njëfar Ka'b bin Eshrefi kërkoi prej Pejgamberit që të ia përshkruajë Zotin e tij. Si përgjegjje në këtë kërkesë, zbriti nga Allahu xh.xh. kjo kaptinë:

«Kulhuvall-llahu ehad. All-llahu-s-samed.
Lemjelid velemjuled ve lem jekun lehu
kufuvend ehad.»

«Thuaj: Allahu është Një, i Vetmi. Allahut i drejtohen për çdo gjë. Ai nuk ka lind e as që është lindur prej kujt. Dhe askush nuk i gjason Atij.» (El-Ihlasë-1,4)

Allahu është krijuesi i kësaj bote dhe i mbarë gjithësisë dhe është Rregullues, Mbikëqyrës, Furnizues, Sigurues i saj.

Të gjithë trupat në kosmos janë të krijuar dhe ndërmjet veti dallohen me peshën, vëllimin, madhësinë, lëvizjen dhe shumë specifika tjera. Kur është fjala për trupat që lëvizin me lëvizje vetjake, ata kanë një raport të caktuar mes peshës dhe fuqisë së tyre e si rezultat i kësaj është shpejtësia e

lëvizjes. Marrim shembull të gjithë trupat e sistemit tonë diellor (planetet, satelitët, diellin etj.). Secili prej tyre lëvizë në orbitën e vet dhe secili ka shpejtësinë e caktuar të lëvizjes në mënyrë shumë precize. Gjithashtu në mes tyre ekziston edhe largësia e caktuar dhe shumë raporte tjera të cilat kanë bërë të mundshme që asnjëherë mos të ndodhi ndonjë çrregullim në kosmos (ndeshje mes trupave apo ndalje e lëvizjes së tyre).

Shtrohet pyetja se si janë vendosur në mënyrë aq precize nëpër vendluindrimet (orbitat) e tyre në gjithësi dhe në çfarë semafori bazohen që të rresktojnë në mënyrë kaq precize përparësinë e njëri-tjetrit? Nëse e kërkojmë përgjegjen në mënyrë të sinqertë dhe duke u bazuar në metodën teologjike, atë do ta gjejmë në Kur'an:

«Inne fi halkis-semavati vel-erdi
vahtilafil-lejli ven-nehari le ajatun li
ulil-el-bab.»

«Me të vërtetë në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në ndërrimin e natës dhe të ditës (dukjen dhe zgjatjen e tyre) ka argumnte për mentarët» (Ali Imranë, 190)

Të njëjtën përgjegje do ta gjejmë edhe nga shkencën por, kërkohet sinqeriteti dhe durimi gjatë studimit.

Pas kësaj pason edhe pyetja tjetër se prej nga e marrin trupat energjinë e lëvizjes apo çfarë force i detyron të lëvizin në mënyrë të pandërprerë?

Disa prej atyre të cilët nuk pajtohen se fuqia mbinatyrore e mban gjithësinë, këtë përgjegje do të ia lënë rastit. Por ta dinë të tillët se asnjë send apo fenomen në gjithësi nuk ekziston rastësisht prandaj është e palogjikshme dhe absurde që të i mbështetemi rastit. Mirë, atëherë po themi se forcat e ndryshme janë burim i lëvizjes së trupave. Por edhe forca duhet ta ketë ndonjë burim sepse as ajo nuk ekziston vetvetiu dhe as trupat nuk janë burim i forcës d.m.th. se edhe forcat e ndryshme janë të krijuara, ashtu si edhe trupat. Sa do të ishte e logjikshme sikur të thonim se një njeri jeton por ai kurrë nuk ushqehet por vetvetiu apo rastësisht ka forcë për të jetuar?

Këtu ka diçka të cilën logjika e njeriut, sado që të jetë e zhvilluar, nuk mund ta zbulojë vet pa ndihmën e Allahut. Arsyeja e tij e zbuloi pyetjen të cilës iu përgjegy Ai i cili e krijoi gjithësinë dhe njeriun. Pra Ai nëpërmjet shpalljes e njoftoi njeriun:

«Kul huvall-llahu ehad» – «Thuaj: Ai është Një, i Vetmi!»

Ai është një Allah i cili krijoi gjithë çka ekziston dhe tek Ai u desh të mbështetet njeriu për të gjetur zgjidhjen e enigmës së ekzistimit të botës. Edhe pse njeriu ka zbuluar se toka sillet rreth boshtit të vet dhe hëna sillet rreth tokës e pastaj të dyja së bashku rreth diellit, ai nuk ishte në gjendje të gjejë shkakun e një dukurie të tillë. Këtë e ka zbuluar njeriu vonë sepse qysh para 14 shekujsh Kur'ani na ka shpjeguar për një dukuri të tillë por ne nuk i besuam derisa u bindëm edhe vet ngase nuk e njihnim natyrën dhe na dukej e pamundshme që toka të sillet rreth diellit. Kështu, sot pasi edhe shkencërisht është vërtetuar një gjë e tillë kemi filluar të bindemi se me të vërtetë toka po u sillka rreth diellit. Por shkencën e «tradhëtoi» njeriu dhe nuk ia prezentoj edhe shkakun e këtyre fenomeneve sepse as vet shkencën nuk është në gjendje të përshkruajë Allahun i cili është Burim i shkencës dhe dijes njerëzore. prapë iu desh njeriut të kërkojë ndihmë nga Allah i cili nuk ngurroi të i përgjigjet ashtu sikur nuk ngurron që «të jepë shembullin e mushkajës ose diçka më të madhe se ajo (2-26)». Sepse:

«All-llahus-samed» – «Allahut i drejtohen për çdo gjë».

Me logjikën tonë dhe të arriturat shkencore kemi arritur vetëm të gjejmë pyetjen: «KUSH QENDRON PRA KËSAJ?». Kështu u arrit gjysma e suksesit apo më mirë të themi se ky është suksesi më i madh për njeriun sepse neve na përkiste vetëm gjetja e pyetjes, e përgjigjen e dha vet KRIJUESI i Cili:

«Lem jelid ve lem juled» – «Nuk ka lindur e as që është i lindur prej kujt.»

Në shikim të parë, kjo përgjegje duket çuditëse sepse, nga përvoja dihet se asnjë gjallesë nuk ek-

ziston vetvetiu por duhet doemos ta ketë lindësin-prindin. Apo thënë më konkretisht, çdo njeri është i lindur dhe zakonisht edhe lind prej tij pasardhësi. Shpesh ndodhë që njeriu të vdesë duke mos lënë pasardhës mirëpo duhet doemos të ketë lindur prej dikujt. P.sh. Ademi a.s. nuk ka pasur prindër sepse është krijuar prej dheut por prej tij ka rrjedhur lloji njerëzor në tokë. E Allahu nuk është i lindur prej askujt sepse është i përhershëm dhe nuk ka ekzistuar kush para Tij dhe as që ka lindur kush prej Tij sepse në këtë rast do të kishte shumë zotra e kjo nuk i përgjigjet Allahut i cili është «Një, i Vetmi». Dhe përfundimisht:

«Ve lem jekun lehu kufuven ehad» – «Dhe askush nuk i gjason Atij.» Çdo gjë që ekziston në këtë botë ka fillimin e vet sepse të gjitha janë të krijuara dhe për këtë shkak të gjitha edhe do të i nënshtrohen shkatërrimit. Pos Krijuesit, që është i Amshueshëm (nuk ka fillim as fund) të gjitha të tjerat janë kalimtare, sepse Ai nuk është i krijuar prandaj edhe nuk i nënshtrohet shkatërrimit. Dikush mund të shtrojë pyetjen se pse edhe Ai të mos jetë i krijuar? Gabimi i parë që bëhet me këtë rast është mënyra se si parashtrohet pyetja, sepse Krijuesi nuk është krijesë prandaj nuk është e domosdoshme që të jetë i krijuar. Ai është ekzistencë e domosdoshme (vaxhibu-l-vuxhudë) kurse gjithë çka ekziston pos Tij janë ekzistenca të mundshme (mumkinu-l-vuxhudë). Ç'kuptohet nga kjo?

Allahu është i domosdoshëm sepse është i Pafillim dhe i Pambarim. Nuk ka ekzistuar ndonjë kohë që të mos ketë ekzistuar Ai dhe as që mund të mendohet kohë e ardhme që të mos ekzistojë. Arsyeja është se nuk është i krijuar – nuk ka fillim për ç'shkak nuk do të i nënshtrohet shkatërrimit – nuk do të ketë fund.

Ndërsa sa u përket të tjerave, që janë të mundshme, ato kanë fillimin dhe mbarimin dhe këtu bëjnë pjesë të gjitha tjerat përveç Allahut. Ato janë aksidentale sepse ekzistojnë apo kanë ekzistuar por ka qenë e mundur edhe të mos ekzistojnë – nuk është i domosdoshëm ekzistimi i tyre. Janë të krijuara – kanë fillimin dhe gjithësesi do të i nënshtrohen edhe shkatërrimit – kanë edhe fundin. Pra janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë dhe mund të përcaktohet edhe me datë ekzistimi i tyre p.sh. unë dhe moshatarët e mij jemi 17 vjeçarë sepse kemi lindur më 1971 d.m.th. më 1970 nuk kemi ekzistuar dhe pas një kohe, të gjatë a të shkurtër, do të i nënshtrohemi shkatërrimit (nuk do të ekzistojmë).

Mund të parashtrohet pyetja: Ç'është e gjithë kjo shëtitje nëpër planeta e trupa të ndryshëm qiellor apo ç'janë këto gjallesa të ndryshme që i marrim si shembull kur po flasim për ekzistimin e Allahut?

Ai është, të cilin nuk e arrijnë shikimet kurse Ai i arrinë shikimet. Është i padukshëm (transcendent) dhe i pakufizuar në kohë dhe hapësirë. Ekzistimin e Tij e shpjegojmë me argumente të ndryshme duke marrur shembuj të gjithë trupat dhe gjallesat në ekzistencë. Mirëpo assesit nuk

mund të flasim për Qenien e Tij sepse është e pamundshme njohja e Qenies së Lartë. Muhammedi a.s. ka thënë:

«Tefekkeru fi halkil-lahi ve la tefekkeru fi dhatil-lahi» – «Mendoni në krijaturën e Allahut (atë çka ka krijuar) e mos mendoni në Qenien e Allahut.»

Njeriu nuk guxon të mendojë se si duket Allahu apo çfarë pamje ka Qenia e Tij sepse mund të gabojmë dhe ta personifikojmë apo të i japim formë e Ai nuk është ashtu. Ekzistimi i Tij manifestohet nëpërmjet krijesave.

Ekrem AVDIU, klasa IV

ISLAM

«Bunijel Islamu ala hamsin: Shehadetu en la ilahe il-la Allah ve enme Muhammeden Resulu-llah, ve i kamis – salati, ve itaiz-zekati ve seumi Ramadane, ve haxh-xhil-bejti men istetae ilejhi sebilan».

«Transmetohet nga Abdullah bin Umer bin Hattabi se ka thënë: kam dëgjuar të dërguarin e All-llahut duke thënë: Ndërtohet islamizmi në pesë (shtylla):

1. Dëshmimi se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij,

2. Falja e namazit,

3. Dhënia e zekatit,

4. Vizita e Qabes (haxh-xhi) dhe

5. Agjërimi i Ramazanit

(Buhariu dhe Muslimi)

Sipas kësaj deklarate të Muhammedit a.s. kuptohet se Islami si ideologji dhe fe e shpallur prej All-llahut themelohet në pesë konditat e lartëpërmendura pa të cilat nuk do të ishte siq është dhe nëse ndonjëra prej tyre nuk realizohet, islamizmi i njeriut nuk është i plotë. Edhe burimi kryesor i Islamit–Kur’ani, flet për bazat e kësaj feje dhe qëllimet e saja të pastërta dhe thotë:

«Feja e vërtetë tek All-llahu është vetëm islamizmi. Ata të cilëve u është dhënë Libri nuk ranë në konflikt derisa u erdhi njohuria për këtë, (e pastaj ranë në konflikt) për shkak të zilisë në mes tyre. E kushdo që i mohon argumentet e All-llahut-All-llahu është i shpejtë në llogaritje.» (3-19)

D.m.th. Fe e vërtetë, e plotë dhe e vetmja e pranuar tek All-llahu xh.xh. është feja Islame. Pasiqë vetëm kjo fe është e shpallur prej All-llahut, asnjë fe tjetër nuk meriton të pasohet përveç kësaj sepe, kjo është ngritur në themelet e njësisë së Zotit (TEVHID) – Edhe prijësit fetarë të ebrejëve dhe të krishterëve në fillim nuk kundërshtuan këtë, përderisa morën vesh qëllimin e islamizmit e pastaj filluan fushatën e tyre kundër fesë Islame nga zilia dhe frika se mos po i humbin pozitën e tyre. Por kushdo që i mohon argumentet e All-llahut për së shpejti e sheh ndëshkimin e merituar sepse All-llahu është shumë i shpejtë në llogaritjen e veprave të tyre.

Bejdaviu thotë se qëllimi me «ata të cilëve u është dhënë Libri» është për ebrejtë dhe të krishterët

e Nexhranit ose të gjithë popujt e mëparshëm të cilët posedonin libra të shpallura. Pas shpalljes së Islamit lindi konflikti në mes tyre sepse disa e pranuan këtë fe kurse të tjerët e mohuan. E këta (mohuesit) thonin se islamizmi është shpallur vetëm për arabët. Këtë e bënë ngase kishin zili ndaj Muhammedit a.s. dhe donin të i ruanin pozitën e tyre që kishin mbi popullin injorant.

«A mos kërkojnë fe tjetër përveç fesë së All-llahut? E Atij iu kanë nënshtuar kush është në qiej dhe në tokë, me dashje dhe padashje dhe tek Ai do të rikthehen.» (3-83)

Komentatorët e njohur të Kur’anit, Fahrudin er-Raziu dhe Hazini thonë se ebrejtë dhe të krishterët pohonin se feja e tyre është feja e Ibrahimit a.s. Muhammedi a.s. u tha se asnjëra palë nga ata nuk janë pasues të fesë së Ibrahimit. Atëherë të dy palët u zemëruan dhe i thanë se edhe ne nuk jemi të kënaqur me fenë tënde. Për këtë shkak zbriti ajeti i lartëpërmendur.

Prej ajetit kuptohet se fetë tjera, pos islamizmit nuk janë fe hyjnore. Por, ebreizmi dhe krishterizmi janë themelisht fe të shpallura, e si mund të thuhet se nuk janë hyjnore? Pasi u shpall feja Islame, feve tjera nuk u thuhet se janë hyjnore sepse janë të anuluar. Prandaj kur një ligj anulohet me një ligj të ri ai më nuk është i plotëfuqishëm.

«E atij iu nënshtua kush është në qiej dhe në tokë, me dashje dhe padashje...»

shtrohet pyetja: nëse engjujt iu kanë përrulur të gjithë ligjit të All-llahut, por njerëzit jo të gjithë, atëherë pse thuhet: kush është në qiej dhe në tokë?

Qëllimi me nënshtimin padashje (me dhunë) është se ligjit të All-llahut iu kanë nënshtuar të gjithë njerëzit pa marrë parasysh a besojnë apo jo sepse ata jetojnë në atë mënyrë si e ka hartuar All-llahu ligjin e jetës në tokë: lindin, ushqehen, rriten, zhvillohen dhe vdesin. Gjithashtu këtu aludohet edhe në ata të cilët besojnë vetëm pasi të iu «vie shpirti në fyt» sepse atëherë shohin dhe i përjetojnë vuajtjet e jetës tjetër dhe i kthehen të drejtës por meqenëse është besim me dhunë nuk u bënë dobi atyre (shembulli i faraonit në kohën e Musait a.s. kur po mbytej në det)

«Dhe kush kërkon fe tjetër përveç Islamit nuk i pranohet atij dhe ai në botën tjetër do të jetë prej të humburve.» (3-85)

Pasi u shpall feja Islame, fetë tjera u anuluan dhe fe e pranuar tek All-llahu mbeti vetëm ajo.

Prandaj kushdo që të kërkojë dhe të pasojë fe tjetër pos islamizmit nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë nga ata që janë të dëmtuar. Dëmi në botën tjetër është me ngelë duarthatë prej shpërblimeve, me e merituar ndëshkimin e All-llahut dhe me mbetë gjithmonë i mjeruar prej humbjes së punëve të mira në këtë botë.

All-llahu xh.xh. pasi e lartësoi fenë Islame, për të treguar për dënimin që i pret ata të cilët nuk ndjekin këtë rrugë, thotë:

«Si do t'udhëzojë All-llahu një popull që mohuan pasiqë patën besuar dhe dëshmuar se pejgamberi është i vërtetë dhe u erdhën argumentet? All-llahu nuk e udhëzon popullin mizor. Ky është shpërblimi i tyre: mbi ta është mallkimi i All-llahut, i engjuve dhe i gjithë njerëzve. Ata përherë do të jenë aty (në peshën e mallkimit dhe dënimit) dhe nuk do të u lehtësohet atyre dënimi dhe nuk do të u jipet atyre afat (pushim). Përveç atyre që pendohen pas kësaj dhe përmirësohen. Vërtetë All-llahu është Falës dhe Mëshirues.» (3-86,89)

Fahrudin er-Raziu dhe Hazini thonë se zbritjen e këtyre ajeteve e shkaktuan 12 personat që u kthyen prej fesë Islame dhe ikën nga Medina dhe shkuan në Mekke. Ndër ta ishte edhe Harith ibn Suvejd i cili posa shkoi në Mekke u pendua dhe u shkroi letër vëllezërve të vet në Medinë që ta pyesin Pejgamberin a.s. se a i pranohet atij pendimi (tevbeja). Vëllezërit e lajmëruan për zbritjen e ajeteve të lartëpërmendura e ai u kthye nga Mekka në Medinë, hyri nën mbrojtjen e Pejgamberit a.s. dhe bëri tevbe.

«Si do të i udhëzojë All-llahu një popull që mohuan pasiqë patën besuar...?» Është larg mendsh që të i kthejë në rrugë të drejtë ata njerëz të cilët mohuan pasiqë patën besuar... sepse ata pasiqë ishin në rrugë të drejtë, nuk u pëlqeu ajo dhe iu dhanë të mbrapshtës, prandaj All-llahu nuk do të i udhëzojë ata edhe pse ka mundësi ta bëjë këtë.

«Dhe patën dëshmuar se pejgamberi është i vërtetë dhe u patën ardhur atyre argumente të qarta.»

D.m.th. Pasiqë u patën ardhur atyre disa argumente të dukshme, besuan dhe pohuan se Pejgamberi është i vërtetë, mirëpo pastaj u kthyen dhe e mohuan të vërtetën. Nga këto fjalë kuptohet se gabimi i të dijshtit është kurdoherë më i rëndë se i të padijshmit.

Ata njerëz që e mohojnë të vërtetën pasi që ta kenë besuar dhe ta kenë ditur atë me argumente të qarta meritojnë dënim të madh.

«Mbi ata është mallkimi i Përendisë, i engjuve dhe i njerëzve në përgjithësi.»

Ata njerëz ndëshkohen me përzërjen nga mëshira e All-llahut xh.xh. dhe të gjithë engjujt dhe njerëzit i luten All-llahut që të i përzejë ata nga mëshira e vet.

Kur thuhet se të gjithë njerëzit luten për mallkimin e atyre që kthehen prej besimit të vërtetë, hyjnë edhe vet ata që janë kthyer; çdo kafir i mallkon kafirat tjerë, por meqenëse veten e numëron në të drejtën nuk e din se edhe vet është në atë mallkim.

«Përveç atyre që pendohen pas kësaj dhe përmirësohen.»

Fahrudin er-Raziu thotë se fjala «ve aslehu» – «dhe përmirësohen» shënon faktin se nuk mjafton vetëm tevbeja (pendimi) por lypset edhe përmirësimi i punës së vet e cila bëhet me kullimin (pastrimin) e zemrës; qëllimin vetëm për të fituar kënaqësinë e All-llahut; stolisjen e gjymtyrëve me kryerjen e obligimeve fetare; shkuarja mirë me të gjithë njerëzit etj.

Për ata njerëz që përmirësohen në mënyrën e sipërtreguar, All-llahu premton se do të ua mbulojë fajet në këtë botë dhe do të i ruajë nga dënimi në botën tjetër, se vërtetë All-llahu është «Gafurun-Rahim» – «Falës dhe Mëshirues».

Ekrem AVDIU, klasa IV

NJË HUTBE

ADHURIMI I ALL-LLAHUT xh.sh.

Vëlezër të nderuar, besimtarë!

Falënderimi, lavdërimi, përlujja dhe adhurimi i takojnë vetëm All-llahut xh.sh. i Cili rrugën jetësore të njeriut e ndriçoi me dritën islame.

Paqa dhe bekimi i tij qofshin mbi Muhammedin a.s. i cili u dërgua mëshirë për botërat. E ka dërguar All-llahu i Madhëruar me të Vërtetën (Kur'anin) përgëzues dhe qortues, për ta paralaj-

mëruar atë që është i gjallë (i vetëdijshëm) dhe për të u vërtetuar fjala (dënimi) mbi mohuesit.

Qoftë lartësuar All-llahu i Gjithëfuqishëm që njeriun, pasi që e krijoi në formën më të bukur, ia shpalli udhëzimin (Kur'anin), në të cilin thuhet:

«O jerëz! Adhuronie Zotin tuaj, i Cili u krijoi juve dhe ata që ishin para jush, nëse doni të ruheni (nga mohimi).» (2:2)

Nga ajeti kuptohet se adhurimi i takon vetëm All-llahut xh.sh. i Cili na ka krijuar neve sikur që i ka krijuar edhe ata para nesh. Prandaj, duke qenë të vetëdijshëm se All-llahu na solli në këtë botë nga mosekzsitenca, jemi të obliguar që ta adhurojmë vetëm Atë, në shenjë mirënjohjeje që na krijoi në formën më të bukur, na fisnikroi dhe na dalloj nga gjallesat tjera me të menduar (logjikë). Pikërisht për këtë arsye, All-llahu i Madhëruar e udhëzoi njeriun dhe ia ndriçoi rrugën jetësore me shpalljen e Kur'anit, pasimi i mësimave të të cilit shpiejn kah lumturia në këtë si dhe paqa e shpëti-

mi në botën tjetër. Ky është dallimi esencial në mes njeriut dhe shtazës.

Dihet mirëfilli se edhe shtazët, jetën fizike e kanë të ngjashme me atë të njeriut: lindin, ushqehen, zhvillohen dhe vdesin. Mirëpo, sa i përket anës shpirtërore, shtazët nuk kanë të menduar, por mënyra e tyre e jetës varet nga instinkti, me të cilin i ka pajisur All-llahu i Madhëruar. Për këtë arsye, shtazëve as që u ka dërguar pejgamberë e as që i ka obliguar me diç.

Pjesa e fundit e ajetit jep të kuptohet se me anën e adhurimit, njeriu ruhet nga mosbesimi, dmth. shihet qartë se nuk mjafton për njeriun vetëm të besojë, por atë besim duhet ta praktikojë me vepra adhurim, sepse besimi pa vepra është i padobishëm, sikurse janë të padobishme veprat pa besim të plotë.

«Ai, i Cili, për ju e bëri tokën shtrat (vendbanim) e qiellin kullm, e prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për ju, pra mos i përshkruani All-llahut shokë, duke qenë se ju e dini (se Ai nuk ka shokë).» (2:22)

Përveç logjikës, me të cilën All-llahu e begatoi njeriun (shpirtin e tij), Ai e furnizoi me të gjitha gjërat e nevojshme për jetë. Në ajet përmendet se tokën e bëri shtrojë, me qëllim që njeriu të jetojë dhe të veprojë në të për të i shfrytëzuar begatitë e saj. Gjithashtu edhe qiellin e ka ngritur mbulojë dhe prej tij e zbret shiun që të ujitet toka për të i dhënë njeriut të lashtat, pemët dhe të gjitha kulturat bujqësore, që njeriu të furnizohet për nevojat e tij jetësore.

Për këto dhe dhunti tjera, të cilat janë të panumërta, njeriu është i obliguar që të adhurojë vetëm All-llahun dhe assesi të mos i bëjë rival Atij.

Se adhurimi i All-llahut është obligim i çdo njeriut kemi argumente të panumërta dhe për më-

nyrën se si duhet të bëhet ai adhurim, na mëson Muhammedi a.s.. Për të qenë sa më konkretë, po bijmë hadithin të cilin e transmeton Muslimi nga Umeri i Hattabit r.a.:

«Ihsan është të adhurosh All-llahun sikurse ta shohësh Atë, se edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.»

«Ihsan», në gjuhën arabe ka kuptimin – të bësh diçka që të duket e bukur. Prandaj, nëse dëshirojmë që shpirtin tonë ta bëjmë të duket sa më i bukur duhet ta adhurojmë All-llahun pandërprejë, dhe që ai adhurim të jetë sa më i bukur, duhet që All-llahun ta adhurojmë sikur ta kemi përpara dhe ta shohim. Është gabim i madh që njeriu të parafytyrojë Krijuesin, sepse Ai nuk ka formë të caktuar dhe përpjekja për personifikimin e Tij shpie në humbje të thellë. Idhujtarët ishin në humbje sepse u përpoqën që All-llahut të i japin formë dhe të i bëjnë rivalë në adhurim. Kështuqë ata iu përulleshin idhujve, të cilët vet dora e njeriut i kishte bërë (prej druri, guri apo materiali tjetër), formë kjo e adhurimit e cila është e papranueshme te All-llahu i Madhëruar dhe ata i pret një dënim i rëndë.

Mirëpo, besimtari i sinqetë duhet ta adhurojë All-llahun sikur ta shohë Atë dhe duhet të ketë parasysh se edhe pse ai nuk e sheh All-llahun, All-llahu e sheh atë.

All-llahu është «semî'un besîrun» – (dëgjon dhe sheh gjithëçka), e sheh edhe adhurimin tonë dhe e di se sa është i sinqertë dhe sa kryhet me përlujtje.

All-llahu qoftë i kënaqur me ne dhe me të gjithë ata që veprojnë sipas udhëzimit të Tij, deri në Ditën e fundit të kësaj bote!

Ekrem AVDIU IV

MBI JETËN E MUHAMMEDIT a.s.

(vazhdim nga numri i kaluar)

II

Muhammedi a.s., në prag të moshës së tij 40-vjeçare, filloi të vetmohej në shpellën Hira, në periferi të Mekkes. Në muajin Ramazan të vitit 610. All-llahu i Madhëruar e gradoi me gradën e Pejgamberit dhe filloi t'i zbrësë Vahji-fjalët e para hyjnore të All-llahut xh.xh.. Pas këtij momenti, Muhammedi a.s. filloi që fshehtas të i thërrasë në fenë Islame.

Të parët që pranuan fenë Islame ishin: Hadixheja (bashkëshortja e Muhammedit a.s.), Aliu (djali i axhës së tij), Ebu Bekri, Zejd ibën Harithi, Uthman ibën Affani, Sa'd bin Ebi Vekkasi, etj..

Tri vite më vonë, Muhammedit a.s. i erdhi urdhëri nga All-llahu që fenë Islame ta predikojë haptas. Në fillim, idhujtarët nuk morën kurrfarë masash për ta penguar, duke shpresuar se askush nuk do t'i përgjigjet thirrjes së tij, por kur filloi Muhammedi a.s. të i kritikojë zotërat dhe besimet e tyre të kota dhe pasi që filluan njerëzit të kalojnë në fenë Islame, ata u angazhuan në çdo mënyrë dhe me çdo mjet për ta penguar përhapjen e fesë Islame, duke filluar prej fyerjeve morale e deri te mundimet psiko-fizike mbi ata që pranonin Islamizmin.

Duke i marrë parasysh vuajtjet dhe kushtet e vështira të muslimanëve, Muhammedi a.s. në vitin e pestë të shpalljes (615 m.) i urdhëroi që sipas mundësisë të shpërngulen në Etiopi. Në këtë vend muslimanët gjetën përkrahje dhe mbrojtje të plotë.

Në vitin 617 paria e Mekkes prunë vendim për të bojkotuar familjen Beni Hashim duke i ndaluar të gjitha marrëdhëniet dhe shitblerjet me ta. Ky bojkotim zgjati tri vite dhe muslimanët përjetuan vuajtje të tmerrshme.

Në vitin 620, Muhammedit a.s. i vdiq bashkëshortja Hadixheja ndërsa pas pak kohësh mbeti edhe pa mbrojtësin më të madh, pos All-llahut të Madhëruar, xhaxhain Ebu Talibin. Me humbjen e këtyre dy anëtarëve të familjes, Muhammedi a.s. humbi dy mbrojtës të fortë dhe besnikë dhe për këtë arsye ky vit u quajt «Senetu-l-huzni» – «Viti i dëshprimit». Në vitin 621 All-llahu i Madhëruar e ngushëlloi Muhammedin a.s. me udhëtimin e jashtëzakonshëm në qiell (Mi'raxh).

Muhammedi a.s. duke i parë kushtet e vështira dhe pengesat që i bënë idhujtarët, përfitoi nga rasti dhe në kohën e haxhit thirrte në fenë Islame me qëllim që misionin e tij ta përhapë edhe në viset tjera të Arabisë. Në vitet 620, 621 dhe 622 bëri tri takime me banorët e Jethribit (Medines) në vendin e quajtur Akabe afër Mekkes dhe këta pranuan Islamizmin. Në takimin e tretë e ftuan Muhammedin a.s. që së bashku me të gjithë besimta-

rët të shpërngulet tek ata në Medinë duke i dhënë besën se do të i mbrojnë sikur anëtarët e familjeve të tyre. Muhammedi a.s. pasi që pranoi propozimet e medinasve, i urdhëroi muslimanët që të shpërngulen gradualisht në Medinë, kurse vet mbeti në Mekke në kushte shumë kritike, derisa edhe vetë emigroi në Medinë më 24 shtator të vitit 622. Ky vit është shënuar në historinë islame si vit historik dhe prej këtu fillon të llogaritet kalendari i muslimanëve.

Muhammedin a.s. dhe muslimanët, aq mirë i pritën muslimanët vendas, sa që u vëllazëruan me ta dhe i bënë pjesëtarë-trashëgues në shtëpitë dhe pasuritë e tyre. Me këtë rast jeta e muslimanëve në përgjithsi u stabilizua dhe kushtet për përhapjen e Islamizmit dukshëm u përmirësuan.

(vijon)

Shashivar KRASNIQI kl. IV.

SADEKATUL – FITRI

(Kontributi i obliguar i Ramazan-Bajramit)

... Ditët po kalojnë. Po afrohet edhe fundi i këtij muajit të bekuar, të cilin me padurim e kemi pritur të vijë, por, sa qelë e mbyll syt u gjendëm në ditët e fundit të tij. Të gjithë, të gëzuar dhe të bindur se adhurimi ynë, i cili në këtë muaj ishte më i theksuar, do të pranohet tek All-llahu i Gjithëmëshirshëm, shpresojmë se edhe me kalimin e këtij muaji do të vazhdojnë veprat tona të mira. Jemi të gëzuar se këto ditë kemi dy festa madhështore, njëren pas tjetrës: Natën e Kadrit dhe Bajramin (idul-fitrin).

Për natën e Kadrit gëzohemi sepse bëhet përvjetori i shpalljes së parë, gjegjësisht, kjo natë na përkujton kohën kur në shpellën Hira zbriti Xhibrili dhe Muhammedin a.s. e njoftoi se All-llahu i Madhëruar e ka zgjedhur për të ua komunikuar njerëzimit mësimet e Kur'anit-Fjalët e të Zotit.

Ndërsa, Idul-fitri na gëzon sepse edhe një herë e zbatuam urdhërin e All-llahut, duke e përcjellur muajin mubarek me ibadet, namaz, lexim të Kur'anit, agjërime etj.. Me përfundimin e Ramazanit gëzohemi që korrëm edhe një fitore në luftën në rrugën e All-llahut-Xhihadun-nefsi.

Ç'është me rëndësi për muslimanët, se përveç agjërimit janë të obliguar që në fund të Ramazanit të japin Zekatul-fitrin – kontributin e obliguar të Ramazanit.

a) Ç'është në të vërtetë Zekatul-Fitri?

All-llahu xh.sh. në më se 30 vende në Kur'an jep urdhër që të zbatohet dhënia e zekatit. Nga kjo kuptohet se dhënia e zekatit është urdhër me

kuptim të përgjithshëm (âm). Mirëpo, për dhënie e Zekatul-fitrit, nuk kemi ndonjë imperativ kur'anor, vetëmse lidhur me këtë merren parasysh disa hadithe të Muhammedit a.s. Në bazë të kësaj, juristët islam, dhënie e zekatit e kanë kategorizuar si obligim kategorik (fard), ndërsa zekatul-fitrin si detyrë të rreptë fetare (vaxhib).

Transmetohet nga ibni Abbasi se Muhammedi as. ka thënë: «Zekatul-fitri është pastrim i agjëruesit nga fjalët e kota dhe të ndyta dhe (njëkohësisht) ushqim për të mjerët dhe të varfërit.» (Buhariu dhe Muslimi)

Ose, sipas Ebu Davudit dhe ibni Maxhes:

«E ka obliguar i dërguari i Zotit zekatul-fitrin, pastrim për agjëruesin nga fjalët e ndyta dhe të kota dhe ushqim për të mjerët dhe të varfërit».

Sipas mësimave të Muhammedit a.s. zekatul-fitri është pjesë e pasurisë të cilën muslimani i pasur e jep në dobi të muslimanit të varfër ose të bashkësisë së gjerë islame.

Kjo ka dy qëllime kryesore:

– sipas dy haditheve të cituara më lartë, ajo pjesë e pasurisë jepet me qëllim që thevabi i fituar nga kjo pjesë e pasurisë të dedikohet për pastrimin e agjëruesit nga mëkatet që ka bërë gjatë muajit të Ramazanit. Pra, kjo është: «Pastrimi i agjëruesit nga fjalët e kota dhe të ndyta». Duke patur parasysh se njeriu është krijesë e dobët dhe shpeshherë, nën ndikimin e cytjeve të djallit të mallkuar, edhe duke qenë agjërues ndodhë që të flet fjalë të pahijshme, të kota apo të ndyta. Me këtë ai e zvogëlon vlerën e agjërimit të tij, duke ditur se muslimani që është duke agjëruar, edhe nëse e fyjnjë me fjalë të rënda, nuk duhet të reagojë ndryshe, vetëmse të thotë «innî sâim» (unë jam agjërues). Prandaj që të pastrohet agjëruesi nga këto gjëra, jepet zekatul-fitri. Ky është vështrimi i zekatul-fitrit nga ana morale.

– Ndërsa sipas hadhithit: «Furnizoni ata (të varfër) në këtë ditë!», sadekatul-fitri jepet që të u bëhet e mundëshme muslimanëve të varfër që, bile për disa ditë të sigurojnë ushqimin për vete dhe

për familjet e tyre. Muslimani i vërtetë, sipas Muhammedit a.s. nuk është ai i cili vet flenë i qetë dhe i ngopur duke ditur se fqiu i tij (qoftë musliman apo jo) është duke vuajtur nga uria. Në raste të tilla, muslimani duhet të ndajë një pjesë të pasurisë së tij dhe të ia jepë fqit (qoftë ai edhe jo-musliman). Ndërsa sa i përket sadekatul-fitrit, ky jepet në dobi të muslimanit të varfër, në fund të Ramazanit, me qëllim që së paku festën e bajramit ta festojë ashtu si i takon muslimanit, sepse Muhammedi a.s. ka thënë: «Furnizoni ata (të varfërit) që të mos dalin këtë ditë për të kërkua ushqim!» Nga kjo kuptohet se asadekatul-fitri u dedikohet muslimanëve të varfër që bile ditën e bajramit të kenë me çka të ushqehen dhe të ushqejnë familjet e tyre. Ky ishte vështirimi i sadekatul-fitrit nga ana materiale.

b) Kush e ka obligim zekatul-fitrin?

Dhënien e sadekatul-fitrit e kanë obligim të gjithë muslimanët e pasur, pa marrë parasysh moshën e tyre dmth. mosha e pjekurisë nuk është kusht që të obligohet sadekatul-fitri, sikur që është tek ibadetet tjera. Sipas kësaj, ky obligim bie edhe mbi fëmijët të miturit. Por këtë do ta bëjnë prindërit e tyre apo kujdestarët e pasurisë së tyre, nëse ata janë të pasur. Nëse fëmijët nuk kanë pasuri personale, për ta do të japin prindërit apo ai që kujdeset për ta. Edhe për ata fëmijë që lindin deri para lindjes së diellit ditën e bajramit jepet sadekatul-fitri, por nuk jepet për muslimanin i cili ka vdekur në këtë kohë. Gjithashtu edhe ai i cili pranon islamizmin në ndër-kohë duhet dhënë sadekatul-fitrin. Kështu, secili musliman i cili kujdeset për një musliman tjetër (bashkëshorten, fëmijët, shërbëtorin, etj.) dhe i cili nuk ka mundësi të japë zekatul-fitrin, ai duhet të japë për të. Sadekatul-fitrin duhet ta japë edhe ai musliman i cili për shkaqe të ndryshme nuk ka agjëruar.

Është me rëndësi të ceket se për të qenë i obliguar sadekatul-fitri, sipas Ebu Hanifes, pasuria e muslimanit, përveq harxhimeve të përditshme, duhet të arrijë vlerën e «nisabit» që është e barabartë me 641,5 gr. argjend.

Tre imamët tjerë (themeluesit e shkollave juridike- «medhhebeve») Maliku, Shafiu dhe Ahmet ibn Hambeli pohojnë se sadekatul-fitrin duhet ta japë ai musliman i cili pas kryerjes së nevojave familiare i mbetet pasuri në lartësi të sadekatul-fitrit.

Ky qëndrim më shumë përmbanë frymën islame – solidaritetin altruist në tërë masën, së paku në këto ditë të gëzimit të përgjithshëm të muslimanëve. Kjo është ngase qëndrimi i të tre imamëve ka mbështetje më të fortë në burimin e ligjit islamik, prandaj ky edhe pranohet në botën islame dhe muslimanët e mbarë botës i mbështeten këtij qëndrimi.

c) Koha e kryerjes së këtij obligimi

Sipas parimit të hadithit të Muhammedit a.s. që muslimanëve të varfër të u bëhet e mundëshme që të furnizohen me nevoja: elementare jetësore në ditët e bajramit, koha e dhënies së sadekatul-fitrit

është në agim të ditës së bajramit e derisa të falet namazi i bajramit. Mirëpo, duke patur parasysh se për të marrë pjesë në gëzimin e përgjithshëm, duhet përgaditur më parë, është shumë më mirë që sadekatul-fitri të jepet para ditës së bajramit, një ditë apo dy por mund të jepet gjatë tërë muajit të Ramazanit.

Këtu vlenë të theksohet se sadekatul-fitri, derisa nuk jepet para namazit të bajramit, mund të jepet edhe pas tij por ajo më nuk është zekatul-fitri por vetëm sadakë e zakonshme.

«Kush e jep atë para namazit (të bajramit) ajo i pranohet dhe kush e jep pas namazit ajo është sadakë e zakonshme.»

ç) Lartësia e sadekatul-fitrit

Lartësia e sadekatul-fitrit është gjysmë «sa'i» grurë apo miell gruri, apo një «sa'» elb (apo miell elb), misër (apo miell) hurma apo rrush të thatë.

«Sa'i» është masë arabe për peshën e cila është e barabartë me 3,332 kg. Si u tha më lartë, gruri apo mielli duhet të jepet në gjysmë «sa'i» – 1,666 kg. Mirëpo, sadekatul-fitri mund të jepet edhe në të holla, duke llogaritur vlerën e ndonjërit nga këta artikuj.

Në kohën e sotme, në vendin tonë, për të dhënë sadekatul-fitrin në të holla, caktohet lartësia e tij nga B I duke llogaritur se sa i nevojiten një personi për tu ushqyer me ushqimin më të lirë, dy herë në ditë.

d) Kujt i takon sadekatul-fitri?

Edhe principi i sadekatul-fitrit është i njëjtë me atë të zekatit, dmth. u takon të gjithë atyre që u takon zekati-atyre personave që nuk kanë mundësi të i sigurojnë nevojat elementare jetësore. Përparësi kanë njerëzit që janë muslimanë të mirë dhe janë të dobishëm për bashkësinë e gjërë muslimane.

Sa u përket personave që nuk bënë të u jepet sadekatul-fitri, prap është e njëjtë me ndalesën e zekatit. Nuk bën që anëtarët e familjes së ngushtë të i japin njëri tjetrit sadekatul-fitrin (fëmiu-prindit, prindi-fëmiut).

Thevabi është edhe më i madh nëse sadekatul-fitri jepet për mbajtjen e institucioneve fetaro-arimore, që janë: medresetë dhe FTI në Sarajevë.

dh) Qëllimi i fitrit

Kryerja e çdo urdhëri të All-llahut xh.sh. është adhurim dhe mirënjohje ndaj Madhërisë së Tij. Në rastin konkret, kryerja e këtij obligimi është mirënjohje ndaj All-llahut për dhuntitë materiale, të cilat Ai ua ka dhuruar njerëzve.

Me dhënien e sadekatul-fitrit manifestohet fryma e solidaritetit dhe humanizmit të muslimanëve dhe delë në shesh dashuria vëllazërore ndërmjet muslimanëve dhe vërehet pastërtia e islamizmit, i cili urdhëron vetëm në punë të mira dhe ndihmë ndërnjerëzore drejtë përparimit të përgjithshëm i cili shkon në dobi të muslimanëve dhe njerëzimit.

Ekrem AVDIU

PSE DHE SI DUHET TA DUAM MUHAMMEDIN a.s.?

Në kohën e sotme është e pamundur që të mos dijmë për ndonjë risi në botën islame, që të mos e njohim më gjerësisht fenë tonë, sepse shtypi fetar në këtë pikëpamje është në një nivel të lakmueshëm. Sipas kësaj, patëm rastin që pak më tepër të dijmë për të dërguarin tonë, Muhammedin paqë dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të. Qëllimi i këtij artikulli është që të përgjigjem në pyetjen themelore lidhur me Muhammedin a.s. e kjo është: pse dhe si duhet ta duam dhe si duhet shprehur dashurinë ndaj tij?

Përveq kësaj, kjo është çështja e dytë themelore e besimit tonë e gjithashtu edhe e jetës.

Në ajetin dhe hadithin vijues do të cekim idenë kryesore të këtij artikulli. Ajeti thotë:

«Kul in kuntum tuhibbûnall-llâhe fettebi'ûnî...»

«Thuaj (o Muhammed): nëse e doni All-llahun, më pasoni mua, do të ju dojë juve All-llahu dhe do të ua falë gabimet. All-llahu është falës dhe mëshirës».

Nga ky ajet shihet se dashuria ndaj All-llahut xh.sh. është ngushtë e lidhur me dashurinë ndaj Muhammedit as. Muhammedi a.s. thotë: «Men ahjâ sunnetî fekad ehabbenî ve men ehabbenî kâne me'ijje fil-xhenneti.»

«Kush e ngjallë sunnetin tim, ai më don mua dhe kush më don mua, ai do të jet me mua në xhennet.»

Gjithashtu nga ky hadith mund të konkludojmë se nuk mund ta duam All-llahun xh.sh. me dashuri të singertë, nëse nuk e dojmë dhe pasojmë pejgamberin tonë-Muhammedin a.s. Nga kjo që u tha më lartë kemi cekur një përgjegje të konsiderueshme në pyetjen e parashtruar, gjegjësisht si dhe sa duhet ta duam Muhammedin a.s. në një masë sa më të madhe që mundemi dhe në këtë duhet të jemi këmbëngulës duke mos iu nënshtruar shejtanit, mashtrimeve dhe mësimëve të tija të errëta.

Shumica mashtrohen dhe mendojnë se çdo gjë është në rregull nëse i pasojnë vetëm urdhërat e All-llahut të cilat janë përfshirë në Kur'an. Natyrisht njeriu edhe atëherë mund të jetë musliman, por nëse besimin e tij e kufizon vetëm me kaq, ai do të i bie në pyetje rregullat themelore të All-llahut xh.sh. Në një thënie është thënë: «Imtësirat janë vlerat e jetës». Kjo është e vërtetë. Sipas kësaj, nëse dëshirojmë të jemi muslimanë të vërtetë patjetër duhet të i dijmë edhe ato «imtësira», p.sh. atë që duhet ta dijë muslimani kur kryen ibadetin; si duhet të flejë, të hajë; si duhet të varroset njeriu, etj. Muhammedin a.s. nuk do ta duam, derisa të mos i njohim këto «imtësira», të cilat kanë rëndësi jetike dhe derisa të mos i plotësojmë në një

masë sa më të madhe. Kërkesa e Muhammedit a.s. nga pasuesit e vet, dashurinë ndaj tij është kërkesë për dashurinë ndaj misionit të tij të pejgamberisë, i cili i është dhuruar dhe i cili në një mënyrë absolute e ka preokupuar jetën e tij morale. Më tutje, ai me këtë ka treguar rrugën drejtë mëshirës së All-llahut të Madhëruar. Në një hadith tjetër Muhammedi a.s. ka thënë:

«Askush prej jush nuk ka besuar derisa të mos i bëhem unë më i dashur se fëmiu i tij, prindi dhe të gjithë njerëzit e botës.»

Sa u përket haditheve dhe ajeteve lidhur me këtë çështje, aso ka mjaftë dhe nuk mund të përmenden të gjitha në këtë artikull të shkurtër, e po i përmendim vetëm disa:

«Edukoni fëmijët tuaj me tri cilësi: dashurinë ndaj pejgamberit tuaj, dashurinë ndaj familjes së tij dhe leximin e Kur'anit.»


Gjithsesi e tërë kjo duhet të bëhet në praktikën tonë dhe Muhammedi a.s. duhet të jetë shembulli më i mirë në jetën e çdo muslimani. Në këtë na udhëzon edhe hadithi:

«Në cilën masë e ke të dërguarin e Zotit shembull, aq je besimtar.»

Duhet të u përmbahemi fjalëve të tija dhe të i marrim shembull sjelljet e tija aq sa kemi mundësi, e këtë na urdhëron edhe Kur'ani: «Ve mâ âtakumurr-rresûlu fehudhûhu ve mâ nehâkum 'anhu fentehû...»

«Çkadoqë u urdhëron i dërguari, atë merreni dhe çkadoqë u ndalon, nga ajo largohuni.»

Nga këto ajete dhe hadithe e pamë se sa është e nevojshme dashuria ndaj Muhammedit a.s. dhe njëherit me këtë u përgjigjem dhe spikatëm qështjen themelore të besimit dhe jetës sonë: pse dhe si duhet ta duam Muhammedin, paqë dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të.



Nexhat NUHIQ IV.

MUHAMMEDI A.S. SHEMBULLI MË I PËRKRYER NJERËZOR

Personaliteti më i madh i botës, me meritën e të cilit gjinia njerëzore është nisur shtigjeve të ndriçara në të sendërtuarit e ardhmërisë së saj, pa dyshim është pejgamberi i fundit i Zotit Muhammedi a.s. Pejgamberia dhe detyra e tij të cilën e ka pranuar nga i Gjithdijshmi vështrohen nga çdo kënd dhe nga çdo pikëpamje. Dëshira e fundit e çdo njeriu të urtë ka qenë që të lërë diç të shkruar mbi personalitetin e Muhammedit a.s. Dëshirën tonë këtë herë do ta përqëndrojmë në Muhammedin a.s. si shembulli më i mirë i mbar njerëzimit.

Krijuesi i gjithfuqishëm u ka treguar njerëzve se feja është thesar i tillë i cili nuk fitohet dhe nuk përjetohet lehtë. Muhammedi a.s. qysh në fëmëni e ka shijuar fatin e jetimit – humbjen e prindërve, pastaj me rend edhe humbjen e farefisit të afërm bashkëshortën Hatixhen dhe të gjithë fëmijët, përveç Fatimes e cila gjysë viti pas tij është shpërngulur në ahiret duke mos mundur të ngadhënjëjë dëshprimin e pafund për të. Kurse, pasi e pranoi shpalljen gjatë 23 vjetëve të ardhshme. Pejgamberi a.s. u ballafaqua me të gjitha fatkeqësitë e kohës dhe botës së atëhershme shkretinore. Kulmi i sprovimit për atë dhe tërë grupin e besimtarëve ka qenë hixhra. Krahas gjithë vështirësive dhe vuajtjeve që i përjetoi, Pejgamberi a.s. asnjëherë nuk dyshoi në misionin dhe detyrën e tij. Dyshimi është shkatërrim për shpirtin e njeriut. Ai e dobëson imanin, ia humb fuqin njeriut dhe mund ta shpie në vetshkatërrim. Muhammedi a.s. këtë e ka tejkaluar me fuqin e shpirtit të tij kur'anor. Sa më të mëdha bëheshin pengesat aq më shumë rritej fuqia e tij, pikërisht ashtu sikur kodrat e mëdha kur i lëshojnë hijet e tyre të thella. Pejgamberi a.s. ka unjisuar çdo forcë të shpirtit dhe trupit, gjakimet e mendjes dhe flakën e zemrës në një fuqi: të jetoi, të fisnikërohet bota dhe të mundet e keqja në mënyrë që të jetë mirë për të gjithë popujt. Thënë shkurt, jeta e tij është rrëfim i shkëlqyeshëm nëpërmjet të cilit lexohet etika kulminante: bota ekziston për shkak të vëllazërisë, fetë vijnë që të bashkohen, kurse Zoti tërheq vërejtjen që të pajtojë.

Fama dhe sukseset e tija pikërisht qëndrojnë në atë, që i frymëzuar dhe i përshkuar me mësimin e Kur'anit ka ditur që në këtë botën vizuale, e cila jeton me jetën e saj vetjake, ta gjejë vendin e vet, t'i harmonizojë dëshirat dhe përprjekjet e tij me rendin dhe ligjet të cilat zotërojnë në botë dhe ka ditur më së miri ta zbatojë fjalën e All-llahut xh.sh. i Sinqert, me tërë shpirtin e tij dhe me tërë qenien e tij i kthyer kah e vërteta absolute, ai, njëkohësisht, ka qenë i sinqert dhe i kthyer edhe kah bota e cila nuk është asgjë tjetër veç se pasqyrë

dhe shenjë e asaj të vërtetë, të cilën si të atillë e ka përjetuar në mënyrë më të fuqishme.

Është vështirë të haset në histori një shembull i tillë i baraspeshës jetësore sikurse është rasti me pejgamberin e Islamit. Pejgamberi ka qenë thellë i vetëdijshëm për këtë të vërtetë. Me plotë të drejtë mund të themi se në atë pikëpamje ka qenë Kur'an i gjallë i cili ka punuar, ka vepruar dhe ka thirrë në Islam, shehadet, në të vërtetën, drejtësinë, dashurinë, barazinë, diturinë...

Është e pamundur mos të pajtohesh dhe mos të mbetesh i magjepsur para famës së Pejgamberit a.s. S'mund të mbetemi indiferent ndaj kaptirave të cilat na flasin mbi atë si bartës i moralit dhe karakterit të përkryer, si njeri, baba, bashkëshort, mësues, edukator, burr shteti, diplomat, ushtar, mik dhe çka jo nga veçoritë dhe virtytet njerëzore. «Jam dërguar që ta përkryej moralin njerëzor», nuk janë vetëm fjalë, por edhe praktikë e përditshme e Muhammedit a.s. gjithashtu jam dërguar të bëhem mësues» nuk janë vetëm fraza por realitet i mësuesit të vërtet, në çdo të mirë njerëzore dhe fisnike.

Duke marr parasysh këtë që u tha deri tash, vijmë në konkludim se, kur është fjala për të zgjedhurit e All-llahut xh.sh. kemi të bëjmë me njerëzit të cilët kanë poseduar veti mbimesatare të cilat i kanë bërë të përkryer në formën njerëzore dhe se vetëm ata kanë mundur të jenë të zgjedhuri për detyrën e cila u është besuar nga All-llahu xh. sh. Asnjë pejgamber i Zotit nuk e ka fituar gradën e vet deri sa nuk e ka flijuar pjesën më të mirë të jetës për luftë dhe përprjekje që ta përgatis veten për këtë. Gjithsesi secili pejgamber për muslimanët paraqet shembullin e përkryershmërisë njerëzore, pra edhe vet Muhammedi a.s. paraqet shembullin e përkryershmërisë njerëzore njëherit edhe të asaj pejgamberike dhe se në të dy drejtimet reprezenton mishërimin Kur'anor të të dy dimensioneve.

Vallë, a nuk është e arsyeshme që Kur'anit e merr për shembull më të mirë në çdo pikëpamje: «Ju keni shembullin më të mirë në Pejgamberin e All-llahut» /XXXIII: 21/. Ky imperativ i është drejtuar mbarë njerëzimit, veçmas muslimanëve. Sikur Muhammedi a.s. të vendoste të jetonte si melek /engjull/ duke e përbuzur çdo gjë të këndshme, ky imperativ do të mbetej shkronjë e vdekur. ai, pra, nuk është melek /engjull/, por njeri dhe njerëzve për pejgamber u dërgohen njerëzit /Hud: 31/.

Përvoja e Pejgamberit a.s. sado që duket jo e zakonshme duhet vështruar si përvojë të përkryer njerëzore.

Qëllimi praktik i këtij shkrimi është të përkujtohem në shumë çështje të cilat na mundojnë në jetën islame, të kërkojmë përgjigje në Kur'an dhe në shembullin e Muhammedit a.s.

Shumë bashkësi të reja islame të cilat formohen anë e mbanë botës, ku asnjëherë s'ka pasur më parë, posaqërisht në kontinentin e Amerikës dhe në Evropën perëndimore, atë veriore dhe qendrore, shpesh pyesim, brengosemi se a do të mund të shkojnë rrugës së formimit të xhematit si ka qenë në fillim të islamit, a do ta ndjekin shembullin e Muhammedit a.s. dhe a do të shfrytëzohet xhamia në atë qëllim që e ka shfrytëzuar Pejgamberi a.s. Çka do të thoshim ne, të cilët kemi lindur si musliman dhe të cilët jemi të udhëzuar në burimet kur'anore dhe të sunnetit? A na brengos edhe neve fakti se në shumë çështje nuk jemi duke e ndjekur Pejgamberin a.s.? Si duket, ne muslimanët ende nuk e kemi kuptuar «IKREN». Fatkeqësisht, këtë imperativ kur'anor nuk e kemi marr mjaft me seriozitet. Domethënien dhe rëndësinë e «IKRES» ne nuk e kemi kuptuar këtë ashtu si e ka bërë Muhammedi a.s. Nuk ka besim pa përpjekje, pa angazhim, pa investim të fuqisë, pa hulumtim. Nëse dëshirojmë ta gjejmë mënyrën më të mirë të mësim-besimit si për të rritur njashtu edhe për fëmijë si edhe për përgatitjen e nënës për punë islame me fëmijët, të pyesim si e ka bërë këtë Pejgamberi a.s. Ai ka lënë jo vetëm përmbajtjet por edhe metodat e punës,* prandaj edhe All-llahu xh.sh. për të thotë: «Ti, vërtet, je në shkallën më të lartë të moralit». /El-Kalem: 4/, kurse ai për veten ka thënë: «Unë jam Pejgamber i të gjithë atyre që i kam mbërrirë dhe të gjithë atyre që do të vijnë /lindin/ «pas meje»

Prandaj, kur të flasim mbi elementin e dytë të kelimeit-shehadetit, mbi të besuarit se Muhammedi a.s. është pejgamber i Zotit, kur të flasim mbi të si shembull të cilin muslimanët doemos duhet ta ndjekin atëherë, pa mëdyshje duhet ditur se kjo mund të shprehet dhe të vërtetohet në praktikë, jetë dhe veprimin e caktuar. Vetë fjala, vetëm të deklaruarit e kelimeit-shehadetit, vetëm këndimi i salavateve nuk shpreh asgjë, nuk vërteton asgjë, nuk do të thotë kurrfarë qëndrimi. Solemniteti i synetit apo mevludit në të cilët shpenzohet /konsumohet/ alkoholi paraqet ironin dhe fyerjen më të madhe të personalitetit të Muhammedit a.s. Ai personalisht për vete nuk ka kërkuar asgjë, ka ndaluar që t'i tregohet ndonjë formë e posaçme e rrespektit. Nuk e ka lejuar rrespektin formal të përcjellur me gjepte të jashtme duke thënë se ai nuk është mbreti romak as perandori persian.

«All-llahu dhe engjujt e tij e bekojnë Pejgamberin. O, besimtarë! bekojeni dhe dorëzohuni plotësisht!» /El-Ahzab: 56/.

*/ Për ne është me rëndësi të veçant metoda dhe mënyra e punës së Muhammedit a.s. në zbatimin dhe zgjidhjen e çështjeve fetare se sa vet zgjidhja e jashtme.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. M. Hamidull-llah, Muhammedi a.s. 2, Sarajevë 1983.
2. Ebul A'la El-Mevludi, Ka razumijevanju islama, Sarajevë 1989.
3. El-Fahri, Muhamedov a.s. lik çovjeka i borca - Tuzla - pa vit të botimit.
4. Islamska misao, nr. 50, 1983 Sarajevë.
5. Glasnik VIS-a nr. 7-8, 1971 Sarajevë.
6. Takvimi 1989, Sarajevë, 1989.

AVNI SADIKU

THËNIET E MUHAMEDIT A.S. PËR KUR'ANIN

Edukoni fëminë tuaj me tri cilësi:

- Me e dashtë Pejgamberin,
- Me e dashtë familjen e tij dhe
- Me mësuar leximin e Kur'anit.

Ata të cilët e mësojnë përmendësh kur'anin dhe veprojnë sipas tij) do të jenë nën mbrojtjen e Allahut, atë ditë kur nuk do të ketë mbrojtje tjetër pos mbrojtjes së Tij. /54.tr. Dejemiu nga Aliu ra./ Shtëpia në të cilën lexohet Kur'ani shëndritet (shkëlqen) për banorët e qiellit, sikur që shëndrisin yjet për banorët e tokës. /650. nga Ajshja ra./

*

Ua kamë lënë juve dy gjëra, nëse ju përmbaheni atyre nuk do të humbeni. Ato janë i Libri i Zotit

dhe Sun-neti Im. Këto dy gjëra nuk do të vinë në kundërshtim gjëra në ditën e Kijametit. /673. nga Ebi Hurejra/

*

Më i miri prej jush është ai i cili mëson Kur'anin dhe ua mëson të tjerëve /833. Nga Aliu r.a./

*

Agjërimi dhe Kur'ani lypin shefatë për ibadetgjënë në ditën e gjykimit. Thotë agjërimi: O Zoti im, vërtet unë ia kam ndaluar atij ushqimin dhe defrimin gjatë ditës dhe pranoje ndërmjetsimin tim ndaj tij, ndërsa Kur'ani thotë: O Zoti im, vërtet unë ia ndalova atij gjumin gjatë natës, dhe pranoje ndërmjetsimin tim ndaj tij, dhe Zoti iu pranon shefatin. /995. Bejhekiu dhe ibni Omeri r.a./

*

Të i keni në konsiderim dy mjete të shërimit: Mjaltin dhe Kur'anin. (i pari për trupë ndërsa i dyti për shpirtë dhe trupë). /1067. nga ibni Mesudi/

*

Në këtë botë katër janë të vetmuar (garib) e ata janë:

- Kur'ani në mbrendsinë e mizorit (zullumçarit)
- Xhamia në të cilën nuk falët askush
- Mus-hafî, në atë shtëpi, në të cilën ai nuk lexo-
het dhe
- Njeriu i mirë në mesin e popullit të prishur.
/1078. nga Ebi Hurejra r.a./

*

Kush e dëgjon një ajet nga libri Zotit (Kur'ani) Allahu ia dyfishon shpërblimin, Ai do të jetë për të dritë në Ditën e Gjykimit. /1545. Ahmedî nga Ebi Hurejre./ Marr nga: Izbor Poslanikovih Ha-disa» Sarajevë 1985.

PREMTIMI (dhënia e fjalës)

Kur njeriu i premtion dikujt diçka apo jep fjalën se do të punojë diçka për dikent, dmth. se e merr për obligim ndonjë punë. Fjala e dhënë-premtimi është obligim, të cilin njeriu me të drejtë dhe moralisht është i obliguar ta mbajë. Obligimi i kryerjes së premtimit-mbajtja e fjalës së dhënë është gjë shumë e rëndësishme, të cilën All-llahu xh.sh. e përmend në Kur'an shpesh, si faktor në marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe lidhur me këtë, në Kur'an kategorisht urdhërohet:

«Jâ ejjuheli-ladhîne âmenû evfû bil - 'ukûd.»

«O ju të cilët keni besuar! Zbatoni obligimet tuaja!»

Varësisht se për çfarë lloj premtimi është fjala e dhënë, ajo krijon situata me domethënie të paceshme. Në bazë të fjalës së dhënë nga ana e personit, i cili me këtë rast është faktor me rëndësi, personi tjetër, të cilit i është premtuar diçka, i bënë planët e veta, apo kushtet për kryerjen e obligimeve, ku kryerja apo moskryerja e obligimit mund të rezultojë në pasojat e tjetrit (personit të cilit i është premtuar). Por, në çdo rast, moskryerja apo mosmbajtja e fjalës përmbanë te personi pasoja të cilat varen nga lloji i premtimit të dhënë.

Njeriu, i cili ka karakter dhe moral të fortë dhe i cili e çmon veten e tij, nuk do të i premtojë askujt asgjë nëse nuk është në gjendje ta mbajë premtimin e dhënë. Kryerja e obligimit-mbajtja e premtimit është borxh për çdo besimtar në mënyrë të drejtë dhe morale. Sa i përket domosdoshë së kryerjes së këtij obligimi moral, Muhammedi a.s. thotë: «El-va'du dejnun, vejlun limen ve'ade thumme ahlefe.» - «Premtimi është borxh, mjer për atë që premtion e pastaj tradhëton».

Moskryerja e obligimeve të marrura, mosmbajtja e fjalës së dhënë (premtimit), sipas burimeve islame janë burim i padrejtësisë, dyfytërsisë në fe. Kështuqë, Muhammedi a.s., duke përmendur cilësitë e hipokritëve, ka potencuar edhe tradhëtinë në besim, gjë që mund të ndodhë në moskryerjen dhe mosmbajtjen e fjalës së dhënë apo premtimit dhe thotë:

«Kur njeriu tradhëton atë që i besohet.»

Moskryerja e obligimeve apo mosmbajtja e fjalës së dhënë krahasohet me gënjeshtrenë, që është një prej mëkateve më të mëdha si dhe për mosnjohjen e pasojave të rënda që ka gënjeshtria. Në

Kur'an përmendet dënimi i rreptë i All-llahut të Madhëruar për gënjeshtarët:

«Ruajuni! Mallkimi i All-llahut është mbi gënjeshtarët.»

Ndërsa Muhammedi a.s. ka thënë:

«Mjerë ata njerëz, veprat e të cilëve u kundërvihen premtimeve të tyre.»

Muhammedi a.s. nuk i njeh si besimtarë ata njerëz të cilët veprat e tyre nuk pajtohen me fjalët e tyre, fjala vie, kur një person urdhëron për një punë, e vet nuk i përmbahet asaj, apo që nuk i kryen premtimet. Këtë, më së miri mund ta kuptojmë nga hadithi i Muhammedit a.s.:

«Nuk është besimtar ai (person) zemra e të cilit nuk pajtohet me gjuhën e tij.»

Çdo besimtar i drejtë, çdo njeri i cili dëshiron që të ndjehet i nderuar dhe i lumtur në shoqëri nuk do të jepë aq lehtë premtime dhe me këtë rast të marrë mbi vete obligime, të cilat nuk është i sigurt se do të mund të i kryejë, sepse në të kundërtën (nëse nuk e kryen premtimin) do të i ipet cilësia e dyfytërsisë (hipokritit), gënjeshtarit dhe asi cilësi të këqia të cilat njeriu e bëjnë jonjeri. Besimtari i drejtë nuk do të lejojë që të jetë i poshtëruar pse nuk e ka kryer obligimin-nuk e ka mbajtur fjalën e dhënë.

Me siguri se nuk ka punë e cila do të zhvlerësojë njeriun më shumë se gënjeshtria dhe mosmbajtja e fjalës së dhënë sepse me këtë rast njeriu humbë autoritetin e tij në masë.

Muhammedi a.s. ka thënë:

«Nga cilësitë e mira të njeriut islam është të largohet nga çdo gjë që mund ta poshtërojë atë.»

Për të qenë sa më larg këtyre cilësive të këqia që u përmendën më lartë, njeriu, kurrënjëherë nuk duhet të marrë përsipër ndonjë punë, për të cilën nuk është i sigurt se do ta kryejë.

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

«All-llahu nuk e ngarkon askë përtej mundësisë që ka...»

Nga kjo që u tha më lartë shihet qartë se dhënia e fjalës është qështje me rëndësi në besimin islam dhe e cila kërkon nga çdo besimtar që ta zbatojë atë në mënyrë të përpiktë.

Rexhep LUSHTA IV

SHKËNDIJZA ISLAME – EDUKATA E SHOKËVE TË PEJGAMBERIT

Thuhet se Uthman ibni Affani r.a. shkoi te Abdullah b. Mesudi për ta vizituar gjatë sëmundjes së tij nga e cila vdiq. E pyeti se prej çka ankohet?

- Abdullahu: Prej mëkateve të mia.
- Uthmani: Për çka ke ëndje?
- Abdullahu: Për rahmetin e Allahut tim.
- Uthmani: A të ftojme një mjekë?
- Abdullahu: Mjeku më ka sëmuar mua.
- Uthmani: A të dhurojmë për ty ndonjë pasuri?
- Abdullahu: Jo.
- Uthmani: Le të jetë ajo për vajzat tua pas teje. Më në fund tha Abdullahu: Nuk kanë nevojë ato për te. Veç ia lë ato Krijusit të tyre, e Ai është i njohtuar për gjendjen e tyre!!

PESË SEKRATE

El Mensuri e pa engjullin e vdekjes dhe e pyeti atë: Sa më ka mbetur të jetoj? I dha shenjë me pesë gishtrinjtë e tij, e ai u zgjua nga gjumi i friksuar. Pastaj kërkoi që të ia komentojnë ëndrrën e tij? I thanë; se do të jetosh pesë vjetë, e i është thanë; pesë muej. Më në fund e pyeti një dietar i cili i tha: Të është sinjalizuar në pesë gjëra të veçanta të cilat i dinë vetëm All-llahu: «Vërtetë, vetëm Allahu e din ditën e Kiametit, Ai e sjell shiun (e bereqetshëm), e dinë se çka ka në mitër (barkun e nënave), nuk e dinë asnjëri se çka do të fiton nesër dhe asnjëri nuk e dinë se në cilin vendë do të vdesë».

DIALOGU MES NJË DIETARI DHE JOBESIMTARI

Një njeri e pyeti një dietar: Përse cilsohet Allahu si furnizues më i mirë? Dietari iu përgjigj: Allahu është i tillë sepse, poqëse një njeri sikurse ti e mohonë Atë, Ai nuk ia shkëput furnizimin atij.

LAKMIA

Poqëse pytet lakmia, cili është babai yt? Do të thoshte: Dyshimi në mundshmërinë.

E nëse pytet, cili është profesioni yt? Do të thoshte: fitimi i turpshëm. Kurse nëse pytet: cili është qëllimi yt? Do të thoshte: ndalesa (harami).

KALLINJËT

Një i urtë (mençur) ka thënë: Qëndroja para një are me grur, shihja kallinjë që luhateshin në hapsirë, kurse, kallinjë të tjerë me kokë të varur turprueshëm. Pasi-që përqëndrova shiqimin, vëreja kallinjët e parë se ishin të zbrazët kurse, të dytët përplot kokrra të grurit.

KËRKO NGA UNË NDONJË NEVOJË

Hisham b. Abdul Meliku gjatë halifatit (sundi-mit) të tij bëri haxhin, hyri në Qabe dhe në të gjeti Salim b. Abdil-lah b. Umer b. El Hatab r.a. e iu drejtua atij: O Salim! Kërko nga unë ndonjë nevojë!

Salimi: Vërtetë, unë turpërohem që ti drejtohem dikujt tjetër përveç Allahut në shtëpinë e Tij.

Pasiqë Salimi doli nga Qabeja, pas tij doli Hishami e i tha: Tani dola nga shtëpia Allahut dhe, kërko atë që ke nevojë për te.

Salimi: Nga nevojat e ksaj bote apo botës tjetër?

Hishami: Nga nevojat e ksaj bote!

Salimi: Vërtet, unë nuk kamë kërkuar këtë botë (dunjan) nga Posedusi i saj (ALLAHU), atëherë si të kërkoj atë nga ai i cili nuk e posedon atë!

GRUPET E VLLËZËRVE

Nga ajo që i mvishet Halifit Me'mun është fjalla tij:

- Vllëzrit janë tri grupe: Një grupë është sikurse ushqimi, pa të cilin nuk është e mundur jeta, grupa tjetër është sikurse barnat që mundë të ketë nevojë për to, kurse grupa tretë është sikurse sëmurja, e Allahu të largoftë prej saj!

AUTORITETI

Një njeri iu drejtua El Ahnef b. Kajsit: Si u bërë më autoritativ e në popullin tënd? Ndërsa kishte për qëllim nënqimin e tij! Atëherë El Ahnefi i tha: Duke e lënë atë që nuk më përket mua, sikur të intereson ty çështja ime e cila nuk të përket ty.

MË I PËRÇMUARI I NJERZVE DHE MË KRENARI I TYRE

Më i nënçmuari ndër njerzë, është i varfëri i cili i bënë lajka të pasurit dhe i nënshtrohet atij, kurse më krenari ndër njerz është i pasuri i cili nuk e nënçmon të varfurin dhe ia ruan dinjitetin e tij.

i përktheu dhe i përshtati nga arabishtja Fadil Hasani

RIVALITETI NË MES IBLISIT DHE FARAONIT

Iblisi trokiti në derë të Faraonit, Faraoni pyeti: Kush është ke dera? Atëherë Iblisi i tha: A ti propagandon se je Perëndi, kurse nuk e din se kush është ke dera juaj?! Faraoni ia hapi derën dhe i tha: Hyr o i mallkuar. Pasiqë u ulën Iblisi i tha Faraonit: a ka mbi sipërfaqe të tokës më të keq se

unë dhe ti; pasi që ti thue: «Unë jam zoti juaj më i lartë», si dhe «Nuk di për ju zot tjetër përveç meje, kurse unë jam prej atyre që bëjnë krime më të mdha.

Faraoni u përgjegj: Më i keq se unë dhe ti është ai nga i cili vllau i tij kërkon falje, kurse ai nuk pranon arsytimin e tij... e më i keq se ai është ai njeri i cili dëshiron shkatërrimin e begative të vllaut të vet musliman.

MOSDËGJIMI I PRINDËRVE

I Dërguari i Allahut xh.sh. ka thënë: «Dënimin e të gjitha mëkateve, nëse don Allahu, i vonon ato deri në Ditën e Gjykimit, përveç mosdëgjimit të prindërve. Vërtet, Allahu i Madhëruar ia shpejtonë dënimin e mëkatarit ndaj prindërve para se të vdesë».

EDUKIMI I VETVETËS

Është pyetur Ibn El-Mukafiu: Kush të edukoi ty, me tërë këtë edukatë? Ka thënë: Veteja ime. Atëherë i është thënë: Si e edukon njeriu vehtën pa edukator? Ka thënë: Si jo? Ku e shihja ndonjë edukatë të mirë, e mirrja atë, kurse nëse shihja diç të keqe e refuzoja atë. Në këtë mynyrë e edukova vehtën time

DITURIA, PASURIA DHE NDERI

Nga ajo që ka thënë njëri prej të urtëve: Vërtetë, njëherë ishin takuar dituria, pasuria dhe nderi. Pasi që dëshiruan me u nda, pasuria tha: Do të shkoi o ju vllëzër, nëse dëshironi të më gjeni, më kërkonin në atë pallatë madhështorë. Kurse dituria tha: Mua më kërkonin në atë univerzitet të madh.

Nderi mbeti i heshtur, atëherë e pyetën shokët e tij: përse nuk përgjigjesh... Ndërsa unë po qese shkoi nuk do të kthehem më.

E PESTA PANORAMË NË BOTË

Për të arritur deri te Panorama, duhet shkuar deri në jug-lindje të Bagdadit rreth 40 km., në shoqrinë e lumit Tigër, hurmeve, limonëve dhe drunjëve tjerë frutdhënës që kënaqin syrin e vizitistit.

Kjo rrugë shpie te qytetza Medain, aty ku pushon sahabiu (shoku) i ngushtë i Muhamedit a.s. Selman el Farisiu r.a. Disa metra përtej shifet Taku Ivani Kiswa (pjesë harkore nga pallati i Kisraut – mbret Persian). Medaini në të kaluarën ishte kryeqytet, ndërsa Taku ishte pjesë e një pallati të madh, llogaritet se është ndërtuar në mesin e shek. III-të dhe numrohet prej pallateve më të mëdha në botë që është ndërtuar me tulla të pjekura si dhe më i larti, sipas burimeve historike. Shtrihet buzë lumit Tigër, lartësia tij tash arrin 37 m.

Enti i përgjithshëm Irakjan, në afërsi të asaj që ka mbetur nga pallati i Ivanu Kisraut, ka ngritur një tendë tradicionale arabe, nga fijet sintetike e stolisur dhe e shtruar sipas stilit arab.

Byroja e përgjithshme turistike Irakjane e shëndrooi në qendër turistike, në afërsi të asaj që ka mbetur nga Ivanu Kisraut është ngritur hoteli i bukur, shtëpitë, apartmanet dhe restorane të ndryshme.

Disa metra më larg, shifet një ndërtesë me pamje madhështore që ka formë pyrgu të vjetër, e që në të vërtetë është PANORAMA E KADISI-SË», njëra ndër më bashkohoret në botë, mbas Panoramave të Moskës, Leningradit, Belgjikës dhe Koresë veriore.

Përrurimi i saj u bë në vitin 1980, ndërsa është ndërtuar në sipërfaqe prej 2500m² dhe ka kushta-

ur rreth 7,5 milion dinarë të Irakut.¹) Lartësia e kësaj ndërtese arrin deri në 28 m. Nëse ka qenë dashur të arrihet në lartësi të pyrgjeve nëpërmes shkallëve, atëherë në këtë ndërtesë bashkohore këtë rol e kryen ashensori në formë të shkallëve.


Në këtë Panoramë janë pikturuar pamjet e Betejës së Kadisisë e cila ndodhi në mes Muslimanëve dhe Persianëve në vitin 637 m. Pamjet e saj me kujdes janë skalitë në pllaka dhe pëlhurë, gjatësia e së cilës është 110 m. kurse lartësia 15. Detajet e Betejës janë rradhitur në një sipërfaqe prej 1640 m². Në përbërje të panoramës bashkangjiten zëri, drita dhe dekor. Realizimi i disa formave është bërë me anë të pikturimit, skulpturimit ose me anë të dekorit.

Beteja Kadisisë është njëra ndër Betejat vendimtare në historinë e arabëve muslimanëve, nga se ajo i ka hapur dyert para ushtrisë arabe-islame për ta çliruar Irakun, Persinë etj.

PËRKTHEU DHE PËRSHTATI
FADIL HASANI.

EL ARABIJ nr. 369-gusht/1989

¹) një dinar: diku rreth 7,5 DM.



NDARJA E MATURANTËVE

Disa shkojnë, të tjerët vijnë. Çdo moment, çdo ditë, në diç ndodhë ndërrimi. Kështu ka qenë dhe do të jetë gjithmonë në procesin e këtij ligji. Koha e bën të veten. Atë që dikur vetëm e ëndërroja, tani po e përjetoj. Së shpejti zilja do të sinjalizojë ndarjen tonë. E kur të ndahemi, do të nisemi kah takimi i një dëshire. Kush prej nesh ku do të shkojë, kush çka do të punojë, me se do të merret dhe kush si do të jetojë-këtë e di vetëm All-llahu i Madhëruar. Askush tjetër. Pa e hetuar por shumë shpejt po i afrohem ndarjes. Kënga e ndarjes gjithnjë e më shumë dëgjohej në zemrat tona. Këngë e hidhur është ajo. Gjithnjë e më shumë përqëndrohem në bankat tona dhe shikimet i rrotullojmë nëpër klasë.

Dëgjohej zhurma e hapave tanë në korridor edhe ende jemi në klasë duke mbajtur orën e mësimet. Dhe nuk e kemi lehtë. Jo. Jo! Nuk ua besoja atyre që shkuan para meje. Koha erdhi dhe e solli të veten. Në veten time tashmë është ndezur zjarri i ndjenjës së ndarjes. Për atë, shokë, na kuptoni. Mos na përqeshni. Kjo është një goditje e fortë për njerëz. Vështirë e kemi... Duhet të shkohet më tutje. E hidhur është ndarja. Merreni me mend, ne maturantët, një paralelë me dyzetë e shtatë nxënës kemi marrë frymë me një shpirt, sikur një familje, katër vite e kemi ndarë të mirën dhe të keqen. I kemi ndihmuar dhe mbrojtur njëri tjetrin, sikur vëllau vëllaun, pa dallim se nga cila anë kemi qenë, qoftë nga Prizreni, Prishtina, Novi Pazari, Mitrovica e Titos, Rozhaja, Ulqini, Gjilani, Podujeva, Tutini, apo vende tjera.

Merrini me mend profesorët dhe edukatorët tanë, jo si diç tjetër por vetëm si prindërit tanë në familjen më të ngushtë. Në çdo moment na e kanë zgjatur dorën për të na ndihmuar, sqaruar, këshilluar dhe udhëzuar kah rruga e drejtë. Çka tjetër përveqse sikur etërit-prindërit tanë.

Ku do ta gjejmë strehimin tonë? A do të takohemi më ndonjëherë në jetë? A do të i mëshirojë më një shikim të gjithë dhe një buzëqeshje të i bëjë të gjithë të qeshin? A do të ulemi më ndonjëherë kështu të gjithë para një profesori?

Të mendojmë pak: a do të përgjigjemi (për njësitë e mësuara) para Ruzhdiut, Tefikut, Qazimit, Bajrushit, Eminut, Resulit, Naimut, (dr.) Bojës, apo a do të pyesim së bashku edukatorët Sylejmanin, Rustemin, Fadilin dhe Ahmetin që të dalim në qytet, të na e hapin sallën e sportit apo ta përcjellim TV programin? A do të qëndrojmë më ndonjëherë në radhë në restorant që të marrim mëngjesin, drekën apo darkën nga Sherifi, Ramushi, Ismaili? Oh çfarë momentesh janë ato; t'i përkujtojmë momentet e hapjes së Medresesë së re apo shakave që bënim gjatë kohës së lirë dhe shokët të cilët kanë ditur të na bëjnë të qeshim edhe kur ishim më të padisponuar, si: Dautin, Musën, Beqën, Bishën, Jakupin, Zejnelin, Kemën, Mehdi Majancin dhe të tjerët; turniret tona në futboll, basketboll, pingpong, shah, etj. vërtetë ishin ngjarja që mbahen mend gjatë gjithë jetës. Mos ufik shpresë. Shokë, mos thuani se është kjo ndarja, por ndonjë gazmend. Folni dhe bëni shaka do ta kem më lehtë. Dua që në zemrën time ta vulosi një kujtim. Kujtimi është i ëmbël sikur kënga dhe në krahëror gufon. Sytë dhe gojët do të qeshnin, por zemrat nuk lejojnë dhe të dyzetë e shtatë së bashku qajnë sepse ka ardhur koha e ndarjes. Dhe tani buqet kënga nga dyzetë e shtatë zemra sikur të ishte nga një shpirt i vetëm, por atë këngë e dëgjojnë vetëm ata dhe askush tjetër.

Një fat i këtillë i pret edhe të gjithë ata që vijnë pas nesh. Prandaj dëgjoni edhe porosinë tonë:

- Ta duani njëri-tjetrin sikur vëllaun dhe gjithmonë të jeni të gatshëm që të i dilni në ndihmë atij, me të cilin katër vite të plota e kemi ndarë gëzimin dhe hidhërimin, kemi ngrënë bukën dhe mësimet i keni mësuar së bashku duke ia sqaruar njëri-tjetrit ato që nuk i keni kuptuar.

Lusim All-llahun e Madhëruar që ngado që të shkojmë të na ndihmojë dhe të na lehtësojë rrugën drejtë sendërtimit të idealeve të larta për të cilat na porositë Kur'ani Famëlartë.

Adem DEMIROVIQ IV

NXËNËSIT DHANË PROGRAM MEVLUDI

Të enjtën më 12.X.1989 me rastin e ditëlindjes së Pejgamberit as. nxënësit e Medreses organizuan një program të mevludit në xhaminë e madhe të Prishtinës.

Të prirë nga H. Resul ef. Rexhepi dhe prof. N. Tërnavi, nxënësit në mënyrë të organizuar u nisën nga Medreseja. Pas fjalës së namazit të iqindisë nxënësit duke kënduar tekbiere paralajmëruan programin e tyre. Që në fillim fjalën e mori H. Sylejman ef. i cili me pakë fjalë iu drejtue xhematit duke iu përkujtuar rëndësinë e kësaj nate. E në vazhdim tha: të pakta janë fjalët për këtë personalitet islam por mjafton që këtë Allahu në shumë vende në Kur'an e ka lavdëruar.

Nxënësit programin e tyre e filluan me leximin e një ashereje nga Kur'ani as.sh. e në vazhdim

vazhduan me leximin e inserteve nga mevludi kasideve, recitalit. Në këtë program modest në pika të shkurtëra u fol për gjendjen e Arabëve para ardhjes së Muhamedit as., jeta e Muhamedit a.s. para se të bëhej pejgamber, shpallja e parë, dhe për Misionin e tij të lartë pas moshës 40 vjeçare. Programi përfundoi me leximin e pjesës së Kur'anit e cila flet për vlerën e lartë të Pejgamberit a.s. dhe se mjafton që për dërgimin e Muhamedit as vërton Kur'ani famëlartë.

MEVLUD NË XHAMINË E FSHATIT OSTROZUB

Për ndër të ditëlindjes së pejgamberit a.s. mevlud u organizua edhe në xhaminë e fshatit Ostrozub K.K. Malishevë, të cilin e udhëhoqi imami i ri plot elan dhe entuziazëm në punë Selim ef. Paqarizi. Detyrën e imamit e mori nga babai i tij Azem ef. Paqarizi të fshatit Ostrozub.

Fshati Ostrozub është fshatë malor, ku mikpritja dhe bujaria e tyre është tradicionale. Përveqë bujarisë dhe mikpritjes fshatarët e Ostrozubit janë edhe musliman të mirë: Interesimi për mësim-besim gjithmonë është prezent në këtë fshat.

Për nder të ditëlindjes së pejgamberit a.s. xhamati i këtij fshati në krye me imamin organizuan një mevlud. Në këtë solemnitët modestë ishin të ftuar imamët e rrethit përfaqësuesit e K.B.I.-së nga Rahoveci dhe referenti fetaro-arsimor Ali ef. Gashi nga Peja. Para përfundimit të mevludit mbi jetën dhe mësimet e pejgamberit as. foli Rustem Spahiu (edukator në medrese) e pastaj referenti fetaro-arsimor Ali ef. Gashi.

Pas mevludit një gjematli shtroi drekë për hirë të musafirve dhe pjesëmarrësve të mevludit. Në këtë bisedë të përzemërt u folë për gjendjen materiale të bashksisë islame, në theks të veçantë u bë fjalë për kushtet në të cilat punon medreseja.

VEHBI KRYEZIU
IMAM

NGA JETA SPORTIVE NË MEDRESE

Përveç ndjekjes me zell të mësimëve dhe zbatimit të obligimeve të parashtruara nxënësit e Medreses nuk ngelin prapa as në aktivitetet sportive. Me qëllim që jeta e tyre të bëhet sa më e këndshme dhe e lumtur, organizohen një mori aktivitete të lira si letërsi, mevlud, mbrëmje të Kur'anit, sport e të ngjashme.

Pas përfundimit të programit të pranishmëve iu drejtua me një ligjeratë të shkurtër drejtori Medreses H. Resul ef. i cili u foli për rolin e Medresës në pregaditjen e kuadrove të rinj dhe zhvillimin e mendimit fetar ke ne në Kosovë.

Xhamia ishte përplot me xhematë dhe të gjithë mbetën të kënaqur me programin të cilin atë ditë e shfaqën nxënësit.

ADEM OSMANI kl. IV.

Kur e kemi fjalën për sportin është e mënçët që të mos përmendim pjesëmarrjen e ekipit basketbollistik në garat komunale të shkollave të mesme të Prishtinës. Në këto gara ekipi ynë për lojën e treguar dhe sjellje sportive u nderua me një diplomë e cila do të thotë shumë për fillim.

Gjithashtu edhe sivjet, sikur edhe viteve të tjera u organizua turniri në futboll të vogël i cili kaloi në një atmosferë vërtet sportive. Gjithsej u paraqitën 13. ekipe nga të gjitha klasat. Më të suksesshmit u treguan ekipi i maturantëve «MATURANTËT» antarët e të cilit u shpërblyen me nga një dres sportiv. Poashtu u shpërblyen edhe vendi i dytë dhe i tretë me nga një dhuratë modeste. Për të gjitha këto meritat më të mëdha u takojnë udhëheqsve të seksionit prof. Ruzhdi Shabanit dhe ed. Sylejman Osmanit.

E përgatiti:
NURI BERISHA - KL.IV-rë.

NE PYSIM JU PËRGJIGJUNI

Voglush të dashur, es-selamu alejkum!

Kësaj here në fletën tonë dhe tuajën «Nur'ul Kuran» po ju paraqesim lojën tonë shpërblyese. Pyetjet nuk do të jenë të vështira andaj na shkruani. Tre fituset fatlum redaksia jonë i shpërblen me nga një libër, juve të tjerëve ju dëshirojmë fat në të ardhmën.

- Pytjet janë: I. Kur u lind Muhammedi a.s.
II. Pas Muhammedit a.s. halif u zgjodhë? Othmani, Omeri, Aliu, Ebu Bekri, përgjegjjen e saktë rrumbullaksone.
III. Cilin muaj hixhri besimtarët janë të obliguar ta agjërojnë?

Ndoshta pyetjet do të jenë të vështira por lutni mualimët që t'ju ndihmojnë. Redaksia ju dëshiron që të përgjigjeni saktësisht në pyetjet tona. Me fat...

Këshilli redaktus i «NURIT»-
fah.post. 89-38000 Prishtinë.
Rexhep Suma Kl. I-rë


JU NJOFIM ME SHOKUN E RI

SHEMBULLIN TË CILIT DUHET TA NDJEKIM

Voglushë dhe voglushe,
në këtë numër të revistës sonë «Nurul Kur'an»

po ju njohimë me një moshatar tuajin i cili vazhdimisht shkon në xhami. Ky është Naim Zhilivoda, të cilin e takum në xhamin «Sulltan Murat»

të Prishtinës. Pas faljes së namazit të iqindisë shfrytzuam rastin që të bëjmë një bisedë të shkurhtë me të. Është gjashtë vjeçar, në xhami kishte ardhur për të dëgjuar programin të cilin atë ditë e shfaqnin nxënësit e Medresesë, për hirë të ditëlindjes së Pejgamberit a.s. Në vazhdim nga Naimi mësuam se namazin është musuar ta falë që nga moshë 4 vj. Përveç shehadeit dhe salavateve, përmendsh dinë edhe këto sure: Elhamin, pesë ajetet e para të sures Bekare, suren Fil, Kurejsh, Kevther, Ih'las, Felek, Nas etj. Meqë ende nuk dinë shkrim–lexim të gjitha kto i mësoi nga kasetat. Në



ndarje redaksisë së Nurit i dëshiron sukses, dhe shpreh dëshirën që përmes kësaj rubrike të njihet me moshatarët e tij. Naimin e falënderojmë në emër të redaksisë dhe i dëshirojmë sukses në të ardhmën, juve të tjerëve ju porosisim që të ndiqni këtë shembull të mirë...

S.SH.

PUNA ME VIJUESIT E MËSIM-BESIMIT ISLAM NË PRIZREN

Me rastin e ditëlindjes së Muhammedit a.s. me 13.10 – 12 rebiu–1– eWel, pas faljes së namazit të ikindisë, në xhaminë e Mehmet Pashës në Prizren me kujdes dhe interesim të veçant u përcoll solemniteti i Mevludit. Vijuesit e mësim-besimit islam, në mektebin e xhamisë Sinan Katib të Prizrenit, me mual-limin e tyre Muhidin ef. Ahmetin përgatitën një program të këndshëm për xhematlinjtë e qytetit të Prizrenit. Si zakonisht, programi filloi me këndimin e një ashereje e pastaj referenti fetaro-arsimor i KBI Miftar Ajdini mbajti një ligjëratë të shkurtër por mjaft konstruktive. Programin, pastaj, deri në fund e ndoqën me kënaqësi të gjithë të pranishmit.

Imami i ri dhe ambicioz Muhidin ef. Ahmeti kreu studimet në FTI në Sarajevë dhe menjëherë iu përvesh punës në detyrën e shenjtë të imamllëkut. Në mektebin e xhamisë, gjatë pushimeve verore të këtij viti katër orë në javë mbante mësim--

besimin me fëmijët. Me fillimin e vitit shkollor mësim-besimi u reduktua në dy orë në javë – të shtuneve dhe të dieleve. Mësim-besimin e ndjekin më se 40 vijues të rregullt dhe atë prej moshës 8 deri në atë 15 vjeçare. Ata janë mjaft ambicioz dhe si duket do t'i kuptojnë mirë themelet e besimit islam. Një pjesë të madhe të planprogramit e kanë kaluar dhe së shpejti do të fillojnë hyrjen në shkronjat e Kur'anit.

Edhe pse fillestar në këtë detyrë, edhe mual-limi edhe vijuesit, puna e bëri të veten dhe sukseset e para dualën në dritë. Duke marr parasysh se di-sa herë personalisht kam prezentuar në orët e mësim-besimit dhe në pyetjen si i arriti hapat e parë në këtë pikëpamje Muhidin ef. u përgjigj duke thënë se këta janë hapat e parë, sepse sukseset s'mund të arrihen brenda një nate apo një muaji e dy. Junusi a.s. 30 vjet e ka thirrë popullin e vet në islam dhe pas 30 viteve vetëm dy veta i janë përgjigjur thirrjes së tij. Mirëpo, pikërisht atëherë kur Junusi a.s. i humbi të gjitha shpresat, populli u kthyen, e pranuan fenë, edhe pse ai kishte ikur.

Puna me fëmij, thot mual-limi, është punë e vështirë, por shpesh kënaqësia fiton në intenzitet. Sipas mual-limit, puna me fëmijët kërkon që secili mual-lim t'i ketë parasysh tri gjëra: Punën, durimin dhe dashurinë. Këto janë boshti rreth të cilave sillet çdo send e edhe çështja e mësim-besimit me fëmijët. Këta janë mjaft kurrështar dhe kurrështjen



e tyre duhet plotësuar dhe kënaqur me punë, durim (sakrificë) dhe dashuri. Kush nuk i zbaton këto tri principe në jetën e tij, nuk do të mund t'u transmetojë islamit të tjerëve, veçanërisht jo të rinjëve.

Nganjëherë, vërtet, nevojitet durim i madh në mënyrë që të gjithë fëmijët të mbesin të kënaqur

duke u përgjigjur në pyetjet e tyre aq të shumta. Afërsia dhe dashuria, gjithashtu janë vendimtare për sukses në punë me fëmijët, përfundon mual-limi.

Mungesa më e madhe momentalisht ndihet për një libër leximi islam apo diç të ngjashme. Mirëpo këtë mungesë, thotë Muhidin ef., me ndihmën e All-llahut, do ta plotësojmë me librin «Edukata moralo fetar», e cila është në përgaditje e sipër.

Siç u njoftova në Prizren së shpejti, me përkryerjen e mektebit të xhamisë Sinan Katib do të fillojë edhe mbajtja e mësim-besimit për të rritur edhe pse në Prizren qysh më heret ka pasur disa përpjekje të suksesshme.

Me punën dhe qëndrimin tonë ndaj punës dhe ndaj njerëzve në rrethin në të cilin veprojmë, ta fitojmë besimin e rrethit, e kjo është mundësi e vërtetë për një punë më të thellë.

All-llahu xh.sh. u ndihmoi mual-limëve në punën e tyre, sepse për sukseset në mësim-besim ata janë meritator.

LUTFI BALLËK

MUHAMMED IKBALI

POEMA E KOHËS

DIELLI është në krahërorët e mi, yjet në palët e rrobave të mia.

Po u thellove tek unë me shpirt, s'jam asgjë. Po e shikove veten unë jam ti.

Në qytet dhe fsaht, në pallat dhe kasollë, unë jam dhembje dhe ai që e qetëson, jam gëzim i pafund.

Jam shpat që i copëton qiejt, jam burim i jetës. Xhingis-Kanët dhe tamerlanët janë vetëm grusht i pluhurit tim.

Trazira e Evropës mezi është e krahasuar me thërrimen e jehonave të mia.

Njeriu dhe kosmosi i tij janë vetëm një nga skicat e mia,

me gjakun e tij stolis pranverën time.

Unë jam zjarr i flakte, parajsa e Gjithlartësuarit. Shiko atë skenë të quditshme: njëkohësisht jam edhe i palëvizshëm edhe i lëvizshëm.

Në kupën time të sotme, shoh si pasqyrohet e nësërmeja.

Në zemrën time shoh mijra botra shkëlqyese të fshehura, shoh mijra yej që qarkullojnë dhe mijra kupa qiellore.

Unë jam petku i njerëzisë dhe veshja e hyjnive. Fati është një prej krijimeve të mia, e edhe liria

njerëzore vjen nga unë. Je Dashnor i Lejles, unë jam shkretëtira e dashurisë sate.

Unë jam sikur shpirti, mbi të të kërkuarit tend. Ti je fshehtësia e zemrës sime, unë jam fshehtësia e sates.

Shprehem me shpirtin tënd, jam i fshehur në shpirtin tënd.

Unë jam udhëtar, kurse ti je caku im. Unë jam fusha, kurse ti fryti im.

Ti je muzika e çdo kompozimi. Ti je shpirti i jetës. O vagabond nga uji dhe balta, shiko paskajshmërinë e zemrës sate:

oqean pa kufi i përmbajtur në kupë.

Nga ajo valë e lartë ngritet stuhia.

Përktheu:

Muhidin Ahmeti

P.S. Kjo poemë është nxjerr nga Eva de Vitray Meyerovitch, Antologjia sufijskih tekstova, Zagreb, 1988. fq. 1988.

KURANI

Bukuri dhe dritë,
shkëlqim shkëndie
i këndshëm si lule
dhe joshës për dije.

Dije dhe jetë,
moral dhe filozofi,
ky është Kur'ani
kush do le ta di.

I ri e i freskët përherë,
eja merri erë:
Lule e pa vyshkur,
arriti në këta shekuj.

Shpirtin ta freskon,
moralin ta forcon,
zemrën ta kënaq,
posa ta lexon.

Pra merre or shok,
lexo mos rri kot,
shpirtin tënd freskoje
dhe me dije pasuroje.

Këto pak fjalë që i thamë
pak janë për Kur'an,
por Zoti na shpëtoftë
dhe në rrugë të drejtë na qoftë.

MUHAMED EGRIU
KL.II-të b

NAMAZI

Ne në namaz
gjithnjë jemi të parë,
kurr asnjë vaktë
se lëmë pa falë.

Në pesë vakte
namaz i falim,
për këtë arsye
gjithnjë fitus dalim.

Emrin Allah,
kushë e përmend
gjith dëshira tij,
do të plotsohet me vend.

ALLTAJ HYZEIR
KL.I-rë a

E KAM NJË VENDBANIM

E kam një vendbanim,
pa punë e pa përtrim,
këtë e kamë fituar,
vetëm me mësim.

Qëndron në skaj qytetit
e mua më gëzon,
e kur shoh nxënës pran saj
zemra më gufon.

Një banim i bukur
asgjë pa i munguar,
vetvetiu e shtyn
nxënsin për të mësuar.

Ka rregull të mirë
e rend mirë të rënditur,
vetëm kështu përpara
suksese ka për të arritur.

I tërë ky o mikë,
është vendbanimi im
dhe këtë e quajnë
Medreseja «ALAUD-DIN».

REFIK GËRBESHI
KL.I-rë a

FEJA ISLAME

Ndër ne fe quhet
një Zot me besuar, nga fuqia e të cilit
të gjithë jemi krijuar.

Disa materialistë,
fenë e quajtën «opium»,
por fenë e kanë përqaftuar
dijetarë të shumtë.

Feja e vetme e shpallur
Islamizmi i vërtetë,
na mëson sjelljet e mira
dhe na bënë të drejtë.

Fenë e vërtetë Islame
kushdo që e pranon,
do të jetë i lumtur
në këtë dhe tjetrën botë.

Nuri BERISHA IV

Për nder të Mevludit

Me gëzim të madh
zgjohemi çdo mëngjes,
me seksionin e mevludit
edhe ne do marrim pjesë.

Së bashku me ndonjë profesorë,
Xhamive ua msymë
dhe me kohë atje,
ne gjithnjë arrimë.

Se njerzit janë mikpritës,
shifet në çdo fillim
në çdo mes që shkojmë
pritemi me gëzim.

Grupi jonë
me program modestë,
bënë të rrjedhin lotë,
nga të rinjtë dhe pleqtë.

Në ndarje me xhemat dhe imamë,
bëjmë nga një intervistë
shumë të knaqur mbesim
që mbajnë mësim-besim.

Voglushët dhe voglushet,
pas mësimit nxitojnë,
për fenë e ALL-LLAHUT
sa më tepër të mësojnë.

Me gëzimë nganjë xhematli
për musafirët shtron drekë,
për të gjitha këto
Zoti i shpërbleftë.

Selatin Shala

BESIMTARI I RI

Një fëmij i vogël
me libër në dorë
kishte marrë rrugën
e shkonte në shkollë.

Përpos shkollës
që marshonte i gëzuar
shkonte edhe n'xhami
kur'an për t'msuar.

Në fillim të mësimit
kishte vështirsi
por pas mësimit të shkronjave

ai ndjeu shumë knaqsi.

Gëzimi i atij fëmiju
nuk kishte të ndaluar
i lumi ai o vllëzër
kur'an din për të lexuar.

E tërë familja tij
ishinë të gëzuar
kur voglushi hatmen
kishte përfunduar.

Të marshojmë o miq
të gjithë në drejtsi
duke marrë shembull
besimtarin e ri.

Refik Gërbeshi Kl. I-rë.

ENIGMA NUMRUAR


- Nëse ju dhimset që ta kaloni kot kohën e lirë
atëherë provoni që ta zgjidhni enigmën e «NUR--
IT». Në fillim ja disa sqarime:

- në katrorin me numër 1(një) shënoni shkronjën (A)
- në katrorin me numër 4 (katër) shkronjën (I)
- në katrorin me numër 11 (njëmbëdhjetë) shkronjën (SH)
- në katrorin me numër 14 (katërmëdhjetë) shkronjën (U)
- në 16-J, 19- TH, 26-B....

Rubrikat tjera plotsoni në bazë të logjikës dhe në fund na del një anektodë e bukur e Nastradinit.

E PËRPILOI:

SULTAN ABAZAJ, Kl. II-të



KRIJUESI

Zoti i Madhëruar
nuk është i krijuar,
çdo gjë në këtë botë
Ai ka krijuar.

I pa fillim, i pa mbarim,
Zoti është një
dhe vetëm Ai meriton laydërim.

Të gjithë e dinë
se Ai është krijuesi
të menqurit e besojnë,
disa të tjerë nga urrejtja e mohojnë.

Edhe urrejtja edhe mohimi
janë një lloj mashtrimi
dhe për ata garantohet pikëllimi.

Dukagjin SHAMOLLI IV

PLOTSIMI I FJALËVE TË NDËRPRERA

HORIZONTALISHT:

1. Muaji në të cilin u lind Muhamedi a.s. (sipas hixhretit) 2. Zanorja e dytë. - një revistë Sarajevase, e- Libri i cili iu shpall Muhamedit a.s. 3. Fëmiu më i vogël i prindërve, - një bashkëtingëllore. 4. Jordania (ar), - vezë peshku. 5. Variola, - Lutja e mëngjesit. 6. Një peygamber i Zotit i cekur në Kur'an, - minus (shkurtimisht). 7. Organizata ndërkombëtare, - kanceri, - shkruaj: Lari. 8. Mjalti (sr), - vijë e ujit, - emër mashkulli. 9. Pjesëz pohore (ar), - fitime. 10. Qytet në Libi, - një zanore, një bashkëtingëllore, - tonelatë. 11. Përmër vektor, - rikuizit sporti, - përmër pronor.

VERTIKALISHT:

1. I dërguar-markë e njohur orësh. 2. Një zanore-nevojë e madhe për ushqim-emër mashkulli. 3. Kryeqytet i Irakut - fryma. 4. Peygamberi i cili paralajmëroi ardhjen e Muhamedit a.s. - flori - variolë. 5. Uranë - dy bashkëtingëllore - një shkronjë arabe - kalë shale. 6. Litër - një zanore, një emashkullores - Kryetari i Indonezisë. 7. Emir Kushtetria - Kthyrje (ar) - zanorja parë - një bashkëtingëllore. 8. Përmër vektor i vetës së dytë shumë në gjuhën frënge - kombet e bashkuara - shtet në veri të Afrikës. 9. Autotarga Vranjës - muaji i agjinimit të muslimanëve. 10. Zanorja e dytë dhe e parë - Bota tjetër (e fundit) - metër. 11. Lufta nacional çlirimtare - bashkimi.

A KENI DITUR SE

Dy zbulues amerikan, dekalrojnë se në pjesën jugperëndimore të malit Ararat në Turqinë lindore zbuluan gjurmët e anies së Nuhit a.s. Ata kanë fluturuar me helikopter mbi malin në lartësi 4400 m. kanë shquar dhe kanë inkuizuar gjurmët e sendeve për të cilat janë të bindur se janë pjesë nga anija në të cilën shpetoi Nuhi as., familja besimtarët, dhe të gjitha llojet e gjallesave tjera. Atë vend, thjeshtë e mbulon gëlqerja, e cila në këtë vitë për shkak të temperaturës së lartë u shkri. Aroni dhe Bob Grejbi vendosën që vitin e ardhshëm të kthehen me ekspedicion prej 20 ekspertësh, në mesin e të cilëve do të ketë; gjeolog, arkeolog... që të vërtetojnë më saktësisht se çka kanë zbuluar këtë ditë. Nuk është hera e parë që mali Ararat të përmendet si «banim» i anijes së Nuhit as. Gjithashtu edhe zbulimet arkeologjike vërtetojnë se në kohët e lashta kjo pjesë ka pasur tërmet, vërshime...

ADNAN ARIFI
NAIM SKENDERI KL.II-të
OMER HUDUTI

1	R	E	B	H	U	L	E	V	V	E	L
2	E		A	S			K	R	A	N	
3	S	U	G	A	R	C					G
4	U	R	D	A	N			K	R	A	
5	L	I	A				S	A	B	A	H
6				D	A	V	U	O		M	I
7				R	A	K			G	A	R
8									Z	E	
9	N	E	A	M			A		A	T	
10	B	E	J	R	A	T			N		T
11					T	I	J			I	M

ZGJEDHJA E FJALËKRYQIT TË NUMRIT TË KALUAR

HORIZONTALISHT: Abit - L - Te- 2. DO-DA - LUMA 3. ETIKA - ILIR 4. MA-IMER-RA 5. IMA -AR 6. MED-EKBER 7. UR-KEPI-NI 8. HARUNI-ATA 9. A-IRAN-RUD 10. MUSA-ASIM 11. EMIN-ISA-B 12. DUA-TM-NUH...

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

فَلِلَّهِ الْحَمْدُ

رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَرَبِّ الْأَرْضِ
رَبِّ الْعَالَمِينَ

وَلَهُ الْكَرِيمُ بَرِيَاءُ

فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ صَدَقَ اللَّهُ الْعَظِيمُ

NÛR

Ketuban

